



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:  
“E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, me profile: “E Drejtë Penale”, dhe  
“E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”  
Universiteti Europian i Tiranës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr. Migena LESKOVIKU**

**Dr. Valbona NDREPEPAJ**

**Qershor / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Master i Shkencave në “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare” me profile “E Drejtë Penale”, “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare” me profile “E Drejtë Penale”, “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”*
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr.74, dt. 21.01.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Riorganizuar me Urdhër MASH Nr. 496, datë 07.10.2011 Ndryshuar me Urdhër MASR Nr. 607, datë 04.12.2017 (ndryshim në emërtim)
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR Nr. 114, datë 19.03.2015
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 35, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohe e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	-
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 3 PAK Për sa i përket ngarkesës 86 % PAE- 14 % PAK
18	Numri i studentëve:	<b><u>Viti akademik 2021-2022</u></b> E Drejtë Penale 31 studentë

		E Drejtë Publike dhe Kushtetuese 10 studentë <b>Viti akademik 2022-2023</b> E Drejtë Penale 26 studentë E Drejtë Publike dhe Kushtetuese 5 studentë
19	Komente / të tjera:	Procesi i vlerësimit të jashtëm vlen vetëm për 2 (dy) profile

\* Emërtimi i programit të studimit është me 3 (tre) profile, por UET nëpërmjet shkresës me Nr.42/1Prot, datë 02.11.2022, kërkon akreditim vetëm për 2 (dy) profilet që janë aktive, profili "E Drejtë Ndërkombëtare dhe Europiane", nuk është pjesë e këtij vlerësimi.

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GJVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit, dosjen e programit të studimit me dokumentacionin shoqëruar, takimet e vizitat e organizuara në institucion dhe dokumentacionin shtesë që institucioni përcolli në ASCAL. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit akademik, aktivitetin kërkimor - shkencor dhe atë ekstrakurrikular, kujdesin ndaj studentit, këshillimin e karrierës dhe tutoriatin, praktikën profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe projektet, etj. Ky program është licensuar për herë të parë në vitin 2009, sipas VKM Nr.74, dt. 21.01.2009, si Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) në: E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare. Programi i studimit u riorganizua nga: DND në E Drejte Publike dhe Nderkombetare ne Msc E Drejte Penale dhe Nderkombetare me profile; E Drejte Penale, E Drejte Publike dhe Kushtetuese, E Drejte Nderkombetare dhe Europiane me Urdhër MASH Nr. 496, datë 07.10.2011, ndryshuar me Urdhër MASR Nr. 607, datë 04.12.2017.

Universiteti European i Tiranës (këtu e në vijim me shkurtimin UET) e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit. UET është institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i akredituar me

Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, dhe pas riorganizimit me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2019. Gjithashtu, UET ka marrë edhe akreditim institucional 5 vjeçar nga Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA).

Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një nga njësitë kryesore të UET-së, në përbërje të të cilit është edhe Departamenti i Shkencave Juridike si njësi bazë e tij. Një nga programet e ciklit të dytë të studimeve që ofron ky departament është Masteri i Shkencave në "E drejtë publike dhe ndërkombëtare", me dy profile, objekt i këtij procesi (riakreditimi). Ky program studimi zgjat dy vite akademike, me kohë të plotë, ofrohet në shqip dhe në përfundim të tij studenti merr 120 kredite ECTS. Programi i studimit është akredituar për një periudhë 5 vjeçare me vlefshmëri deri në 30.09.2023.

### **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Pasi UET ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master i Shkencave në "E drejtë publike dhe ndërkombëtare" me profile, ASCAL bazuar në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë nëkuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017*", ka përzgjedhur dhe kontraktuar dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti, për të kryer vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.Dr. Migena Leskoviku dhe Dr. Valbona Ndrepepaj, profesorë në Universitetin e Tiranës. Gjatë vizitës në institucion dhe procedurës lidhur me vlerësimin e jashtëm, ekspertët e jashtëm u asistuan nga Koordinatorja Teknike e ASCAL Znj. Majlinda Demirmeli.

Ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion gjithë dokumentacioni dorëzuar nga institucioni për vlerësim, fizikisht dhe përmes platformës e-ASCAL, si dhe dokumentacioni shtesë përsa institucioni solli. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Meqë gjatë vizitës, u evidentua nevoja për dokumentacion shtesë, ky dokumentacion i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion pas vizitës në institucion. Në vlerësimin që ka bërë, GVJ ka qenë objektiv, i paanshëm dhe ka vlerësuar mbi bazën e dokumentacionit të sjellë nga IAL për këtë program studimi që i nënshtrohet akreditimit.

GVJ ka përcaktuar shkallën e përmbushjes për secilën fushë në 4 nivele sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL për këtë qëllim. GVJ ka marrë kontakt sipas axhendës 2 ditore të vizitës në institucion, por institucioni duhet të kishte treguar më tepër kujdes dhe të kishte marrë më mirë masa për respektimin e takimeve sipas axhendës, sidomos për takime të caktuara, p.sh. me stafin akademik të programit të studimit, ku GVJ takoi vetëm 3 pedagogë, apo me Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve. Gjithsesi, GVJ falenderon UET për bashkëpunimin dhe disponibilitetin e treguar gjatë vizitës për këtë proces akreditimi.


GVJ pasi u njoh me rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit, në rastin e akreditimit 5 vite të këtij programi studimi (Vendimi Nr.35, dt.13.07.2018), konstaton se ato janë reflektuar nga institucioni dhe përgjithësisht mund të themi se janë plotësuar. Duke vlerësuar arritjet dhe punën pozitive të bërë për këtë program studimi, në fund të këtij raporti, janë dhënë edhe rekomandimet për institucionin si dhe është paraqitur analiza SWOT për programin e studimit që është objekt riakreditimi, me qëllimin e mirë për të ndihmuar në përmirësime të mundshme rregullatore, strukturore, organizimi dhe kompetencash për përmbushjen e standarteve dhe detyrimeve ligjore e statutore, si dhe arritjen e objektivave të kërkuar për një program studimi të ciklit të dytë Master i Shkencave në standarte bashkëkohore dhe të krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara nga institucione të arsimit të lartë perëndimore.

Universiteti European i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.04.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 40 / 19 Prot, datë 23.04.2024. Universiteti European i Tiranës njofton në ASCAL më datë 09.05.2024, me anë të shkresës me Nr.37/10 Prot, datë 03.05.2024 “Kthim përgjigje mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”.

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. Lidhur me komentet për Fushën I-rë, përkatësisht për standartet **Standardi I.1, kriteri 2 dhe 4; Standardi I.2, kriteri 2; Standardi I.3, kriteri 4 me konkluzionet respektive, nuk ka ndryshime në raport.**

Programi i studimit, Master i Shkencave në "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare", në konceptimin e tij ka qenë i ndërtuar me tre profile: "E Drejtë Penale" dhe "E Drejtë Publike dhe Kushtetuese", dhe "E drejtë ndërkombëtare dhe Evropiane". Në këtë kuadër, masteri në titullimin e tij dhe përmbajtjen qendronte pasi një profil lidhej me fushën e të drejtës ndërkombëtare/europiane. Pas riorganizimit të këtij masteri, ku profili i tretë u mbyll për shkak të mosinteresit të studentëve për ta ndjekur këtë profil, GVJ sugjeron riorganizimin e tij që të ketë përputhje mes emërimit të programit dhe profileve të tij. Për më tepër, nga DVV dhe vetë institucioni theksohet se programi i studimit "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare", me dy profile tashmë: "E Drejtë Penale" dhe "E Drejtë Publike dhe Kushtetuese", ka si qëllim, të formojë specialistë të lartë në fushën e drejtësisë, duke i vënë një theks të veçantë njohurive dhe kompetencave që lidhen me drejtimin publik, kushtetues dhe penal, duke iu përgjigjur kërkesave aktuale të tregut të punës në Shqipëri. Pra vetë një riorganizim i tillë nuk e lidh specifikisht në mënyrë të profilizuar specializimin me fushën e të drejtës ndërkombëtare. Si e tillë, titull/emërtimi i programit nuk justifikon pjesën e dytë të tij (ndërkombëtare). Ndaj, GVJ ka sugjeruar që ky program studimi të plotësojë profilin e tij dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare - karakterin e tij ndërdisiplinor, duhet që në të ardhmen të riorganizohet, në mënyrë që të ketë përputhje



ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor. Nëse UET në të ardhmen pret që ky si program të mbyllet (siç e kanë specifikuar në komentet e tyre), duhet parë edhe vlerësimi i kostove dhe trendi në ulje i studentëve për këtë program, si dhe mundësia për riorganizimin e tij si master ndërdisiplinar (që po ashtu është një mundësi që UET mund ta marrë në konsideratë) për të bërë të mundur ndjekjen e tij edhe nga studentë që nuk kanë një diplomë në drejtësi. Kështu që GVJ i qendron konstatimeve të saj në raport dhe konkluzionit përkatës.

2. Lidhur me komentet për **Standardin II.6, kriteri 4 dhe konkluzionet, nuk ka ndryshime në raport**. GVJ e ka evidentuar faktin se Institucioni zbaton konceptin e grantit kërkimor për pedagogët, që mbështeten për aktivitet kërkimor dhe botues të një niveli të caktuar. Por kemi theksuar se gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se për të përfutur këtë grant ishte e vështirë dhe nga personat që kontaktuam (përfshirë Dekanen e fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Juridike) nuk morëm ndonjë informacion se sa persona nga stafi akademik i departamentit të shkencave juridike përgjegjës për këtë program studimi, e kishin përfutur këtë mbështetje financiare në 2-3 vitet e fundit. Kjo evidenton faktin se nga ky departament asnjë nuk e kishte përfutur këtë grant për shkak të kriterëve të vendosura për këtë qëllim. Kështu që GVJ i qendron konstatimeve të saj në raport. Theksojmë se krahas aspektit të përgjithshëm institucional, GVJ interesohet posaçërisht për aktivitetin akademik, kërkimor e shkencor të Departamentit që mbulon programin e studimit që është në proces akreditimi, pasi kemi të bëjmë me akreditim programi ku komponenti kërkimor e shkencor për stafin akademik të programit të studimit është me mjaft rëndësi dhe pjesë e vlerësimit tonë. GVJ ka evidentuar rëndësinë në bashkëpunimin e departamentit me Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve (ZPP), e cila ndihmon në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të Universitetit duke i ofruar shërbim dhe mbështetje administratës së Universitetit, fakulteteve, dhe stafit për të siguruar dhe për të menaxhuar financim të jashtëm për aktivitete të Universitetit. Por në dokumentat e vënë në dispozicion (DVV), nuk del e qartë cilat janë projektet ku përfshihet Departamenti i Shkencave Juridike që mbulon programin e studimit “E drejtë publike dhe ndërkombëtare” dhe për këtë duhet të ishin paraqitur të dhëna më të detajuara. Po ashtu, evidenca e vënë në dispozicion për projektet UET, ishte e papërditësuar dhe ajo përfshin periudhën 2014-2020 dhe nuk ka info.për tre vitet në vijim 2020-2023, duke e bërë informacionin të pa përditësuar dhe të vështirë për GVJ për të pasur këtë informacion të tre viteve të fundit.

Theksojmë se edhe gjatë vizitës në UET, GVJ nuk mori dot info.më tepër në lidhje me projektet aktuale ku departamenti i shkencave juridike është përfshirë nga ana e Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve. Kështu që GVJ i qendron konstatimeve të saj në raport dhe konkluzionit përkatës.

3. Lidhur me komentin për, **Standardi VI.5, kriteri 2, 3 dhe 5 me konkluzionet, nuk ka ndryshime në raport**.

Duket se në vetë komentet e dhëna nga institucioni ka një kundërshti, pasi fillimisht thuhet se KSBC nuk zhvillon kontrolle në nivel programi studimi dhe nga ana tjetër, thuhet se gjetjet e KSBC-së rezultojnë nga kontrollet e standarteve të hartimit të tezave dhe korigjimit të provimeve në lëndë në nivel departamenti, kontrolli i syllabuseve të hartuara, raportet e intervistave me studentët (fokus-grupe).

Kriteri 2 dhe 3 i standartit VI.5 kërkon përgjegjësinë e UET dhe njësive të tij për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit të programit të studimit dhe po ashtu rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

GVJ ka evidentuar se komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit bëhet në përputhje me format e miratuara nga UET, duke e trajtuar në nivel njësie kryesore dhe bazë, e duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe të dhënat personale. Sipas akteve rregullatore, UET publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë akademike, transparencën dhe etikën akademike, LAL dhe akteve të tjera rregullatore në fuqi. Në dokumentacionin e paraqitur (DVV), nuk ka një dokument të KSBC-së që lidhet me gjetjet e këtij programi studimi objekt riakreditimi, apo një analizë departamenti të shkencave juridike në lidhje me këto gjetje. Në këtë rast, shtrohet pyetja se nga të dhënat e mbledhura nga strukturat e cilësisë, sa shërbejnë gjetjet për të përmirësuar programet e studimit në UET dhe konkretisht GVJ interesohet për gjetjet në lidhje me programin e studimit “E drejtë publike dhe ndërkombëtare”; a ka analizë të departamentit për sa rezulton nga këto kontrolle të cilësisë dhe instrumentat që zbatohen?

Në dok. e paraqitur nga UET, përcaktohet se në përfundim të semestrit/vitit akademik, hartohet raporti mbi vlerësimet periodike dhe vjetore, në të cilin pasqyrohen rezultatet dhe bëhet një analizë e ecurisë së programeve të tij, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Institucioni përfshin të dhënat që lidhen me studentët dhe vlerësimin, apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit dhe po ashtu pasqyrohen në raportin vjetor institucional që i paraqitet autoriteteve drejtuese. Në këto raporte pasqyrohen rezultatet dhe bëhet një analizë krahasimore për ndryshimet dhe ecurinë e të dhënave të shqyrtuara, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Por GVJ evidenton se në dokumentacionin e paraqitur, nuk ka një dokument të KSBC-së që lidhet me gjetjet e këtij programi studimi objekt riakreditimi, apo një analizë departamenti në lidhje me këto gjetje. Për GVJ është e rëndësishme jo vetëm aspekti formal i pasjes së rregullave dhe instrumentave të kontrollit të cilësië, por edhe si dhe sa zbatohen ato në funksion të adresimit të mangësive dhe dobësive të evidentuara në një program studimi dhe masat që merren për përmirësimin e cilësisë në secilin rast. Kështu që GVJ i qendron konstatimeve të saj në raport dhe konkluzionit përkatës.

**Kriteri 5 i standartit VI.5** kërkon që Institucioni të organizojë veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në lidhje me këtë kriter, GVJ mendon se në funksion të rritjes së cilësisë, departamenti i shkencave juridike duhet të zhvillojë më tepër aspektin analitik në lidhje me performancën dhe përmirësimin e

vazhdueshëm të standarteve të cilësisë. NJSBC ka një plan punë të aktiviteve të saj, por GVJ nuk evidentoi ndonjë aktivitet konkret me personelin dhe studentët më qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së këtij program studimi, dhe po ashtu nuk na u vu në dispozicion raporti i fundit i kësaj njësie (NJSBC) për programin e studimit objekt riakreditimi. Kështu që GVJ i qendron konstatimeve të saj në raport në lidhje me këto kritere dhe konkluzionit përkatës.


## **SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I MËPARSHËM**

### **I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 35, datë 13.07.2018, janë:**

- 1. Institucioni t'i kushtojë rëndësi mbështetjes dhe nxitjes së stafit akademik të këtij program studimi, për rritjen dhe pasurimin e veprimtarisë kërkimore dhe të publikimeve shkencore;*
- 2. Institucioni të shohë mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve specifike të bashkëpunimit me institucione publike dhe private në shqipëri dhe jashtë vendit për zhvillimin e temave të diplomës dhe formimin praktik të studentëve që ndjekin këtë program studimi;*
- 3. Me gjithë literaturën e pasur në gjuhën angleze, Institucioni të plotësojë dhe përditësojë bibliotekën me tituj tekstesh në gjuhën shqipe duke patur parasysh dhe specifikën e këtij programi studimi.*

### **II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**


- 1. Vëmendje i kushtohet lirisë akademike dhe veprimtarisë kërkimore shkencore nga ana e stafit akademik, duke bërë të mundur pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit. Në këtë drejtim, UET ka krijuar Zyrën e Zhvillimit të Projekteve dhe Partneriteteve me qëllim zhvillimin e projekteve ndërkombëtare, partneriteteve strategjike dhe lehtësimin e aplikimeve për grante kërkimore. Po ashtu, me rëndësi janë edhe mobilitetet e stafit akademik. Në lidhje me mundësinë dhe mbështetjen për efekt publikimi në revista dhe periodikë shkencorë vendas apo në gjuhë të huaj, një mundësi është publikimi në revistën "Ius and Justicia", revistë që publikon Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pa pagesë për stafin akademik. Ndërsa në lidhje me publikimin në periodikë të tjerë ndërkombëtarë në anglisht nuk rezulton që ka mbështetje konkrete për këtë qëllim. Edhe gjatë vizitës në UET nuk gjetëm asnjë shembull të kësaj mbështetje, duke pasur parasysh koston që ka publikimi**






veçanërisht në revista të caktuara ndërkombëtare me faktor impakti/të rankuara sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Për sa më sipër GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

2. UET ka marrëveshje me IAL vendase dhe të huaja. Po ashtu, UET, por edhe njësia kryesore ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave dhe mundësive të tjera bashkëpunimi. Vërehet se, prej këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi janë krijuar lidhje konkrete ndërmjet universitetit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Gjithsesi, këto marrëveshje kryesisht lidhen me aktorë dhe institucione vendase, ku edhe u jepet mundësia studentëve të marrin informacion për temën e diplomës dhe të njihen e zhvillojnë aspektin praktik. Po ashtu, në kuadër të këtyre bashkëpunimeve që ka UET me institucione dhe subjekte të tjerë, mund të fasilitohen studentët në lidhje me hulumtime apo punë në terrën dhe arkiva, marrje informacioni të nevojshëm në funksion të temës, realizim pyetsorësh apo anketimi për efekt hulumtimi etj. Pavarësisht numrit të lartë të marrëveshjeve të bashkëpunimit si institucion, do të sugjerohet rritjen e numrit të marrëveshjeve në nivel fakulteti dhe departamenti. Për sa më sipër GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.
3. Në lidhje me këtë rekomandim, për studentët e programit Master i Shkencave “E drejtë publike dhe ndërkombëtare”, është pasuruar biblioteka e institucionit me disa blerje të reja, botime të 5 viteve të fundit nga Shtëpi Botuese në shqip ose përkthime, të cilat janë konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve, përgatitjes së detyrave të kursit dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe përgjatë punimit të diplomës. Drejtuesi i fakultetit/departamentit hartojnë një plan për shtimin e zërave të bibliotekës, ku pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik. Për sa më sipër GVJ mendon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

04  


9  


**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare” me profile “E Drejtë Penale”, “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sipas Statutit, planit strategjik 2015-2020/ 2021-2025, strategjisë së kërkimit shkencor 2017-2020/ 2021-2025, programet e studimit, në UET, nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Konkretisht, vizioni dhe misioni i këtij universiteti është "t'i shërbejë dijes në dhe për shoqërinë shqiptare". Veprimtaria akademike në përgjithësi, si edhe ajo e zhvilluar në kuadër të programit të studimit Master i Shkencave në "Të Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare, me 2 profile "E Drejtë Penale" dhe "E Drejtë Publike dhe Kushtetuese", mbështetet në misionin e UET, i cili është t'u japë studentëve një edukim cilësor, i bazuar në kërkim shkencor të vlefshëm, mësimdhënie, kreativitet dhe partneritete kombëtarë dhe ndërkombëtare.  (E.2; E.3; E.3.1; E.3.2; E.3.3; E.32; E.34; E.34.26; E.34.27).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit, Master i Shkencave në "Të Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare, me 2 profile "E Drejtë Penale" dhe "E Drejtë Publike dhe Kushtetuese", është i hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Ky program ka si qëllim, të formojë specialistë të lartë në fushën e Drejtësisë, duke i vënë një theks të veçantë njohurive dhe kompetencave që lidhen me drejtimin publik, kushtetues dhe penal, duke iu përgjigjur kërkesave aktuale të tregut të punës në Shqipëri. Mirëpo, që ky program studimi të plotësojë profilin e tij dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, <i>duhet që në të ardhmen të riorganizohet, në</i>

	<p><i>mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor.</i></p> <p><b>(E.2; E.3; E.3.1; E.3.2; E.3.3; E.7).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Sipas DVV, dhe pas verifikimit të akteve të brendshme të institucionit, programi i studimit, Master i Shkencave në "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare, me 2 profile "E Drejtë Penale" dhe "E Drejtë Publike dhe Kushtetuese", është i hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim, Statutin dhe Rregulloret e Institucionit. Po ashtu, ky program është në përputhje me drejtimet prioritare akademike të institucionit, pasi në dokumentet themelore të tij, shprehet fakti se UET synon ruajtjen e profilizimit në shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, IT, komunikimit, etj.</p> <p><b>(E.2; E.3; E.3.1; E.3.2; E.3.3; E.7)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Sipas dokumnetacionit të vlerësimit të brendshëm (RVB), e vizitës në institucion, programi i studimit, Master i Shkencave në "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare, me 2 profile "E Drejtë Penale" dhe "E Drejtë Publike dhe Kushtetuese", është i hartuar edhe në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit.</p> <p><i>Ajo që <u>GVJ rekomandon</u> është që ky program studimi duhet që në të ardhmen të riorganizohet, në mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor.</i></p> <p><b>(E.2; E.3; E.3.1; E.3.2; E.3.3; E.7).</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit, Master i Shkencave në "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare, me 2 profile "E Drejtë Penale" dhe "E Drejtë Publike dhe Kushtetuese", është i hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Ky program ka si qëllim, të formojë specialistë të lartë në fushën e Drejtësisë, duke i vënë një theks të veçantë njohurive dhe kompetencave që lidhen me drejtimin publik, kushtetues dhe penal, duke iu përgjigjur kërkesave aktuale të tregut të punës në Shqipëri.</i></p> <p><i>Mirëpo, që ky program studimi të plotësojë profilin e tij dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare - karakterin e tij ndërdisiplinor, duhet që në të ardhmen të riorganizohet, në</i></p>

	<i>mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi I.2

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka përvojën mbi 15 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse, si dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej <b>48 pedagogë</b>, nga të cilët <b>34 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku: 4 kanë titullin “Profesor”, 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 11 kanë gradën Dr./PhD, dhe 15 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>14 pedagogë me kontratë (PAK)</b> nga ku 2 kanë titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, 7 kanë gradën Dr./PhD. dhe 4 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa në departamentin e Shkencave Juridike për vitin akademik 2022-2023, janë 8 lektorë, si personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asociuar”, 5 me gradën “Dr./PhD” dhe 1 Magjistër. Në departament janë të angazhuar dhe 12 personel akademik me kontratë (PAK), nga të cilët janë 1 me titullin “Profesor”, 6 me gradën “Dr. / PhD” dhe 5 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p><b>(E.20; E.44.1; E.44.2; Aneks RVB – Tabelat përmbledhëse).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e</p>	<p>Ky program studimi ofrohet në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Pjesë e programeve që ofrohen nga ky fakultet janë edhe programet dhe fushat e studimit si Diplomë e Integruar në Drejtësi (DIND), Juridik i përgjithshëm (BA), MSH në të Drejtë Publike dhe</p>

<p>kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Ndërkombëtare; MSH në e Drejte Drivate; MP në Drejtësi. Vetë emërtimi i Fakultetit apo departamentit, ka përmbledhur të gjithë fushat e përgjithshme të studimit në të cilat ofrohen programet specifike të studimit. Që ky program studimi të jetë plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, apo asaj bazë, lind e nevojshme që në të ardhmen të riorganizohet. Kjo, në mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor. Po ashtu, duhet që të plotësohet karakteri i tij ndërdisiplinor. (E.2; E.5; E.7; E.14-E.14.4; E.19).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Sipas DVV, programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ky departament përmbledh fushat e studimit si Diplomë e Integruar në Drejtësi (DIND), Juridik i përgjithshëm (BA), MSH në të Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare; MSH në e Drejte Drivate; MP në Drejtësi. Vetë emërtimi i departamentit, ka përmbledhur të gjithë fushat e përgjithshme të studimit në të cilat ofrohen programet specifike të studimit. Në këtë rast, sërish vlen rekomandimi i mësipërm, në kriterin 2. (E.2; E.5; E.7; E.14-E.14.4; E.19).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Sipas DVV dhe deklaramit të përfaqësuesit të Zyrës së Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit si dhe përmes procesit të Tutoriatit dhe Këshillimit Akademik, ju krijohen mundësi studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar (UET Alumni) që të konsultohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me nevojat e tyre për karrierë dhe riorientim në tregun e punës, përmes panairëve të punësimit, këshillimit, shkëmbimit të</p>

	<p>eksperiencave me Alumni dhe Burimet Njerëzore të kompanive të ndryshme.</p> <p>(E.12; E.27.2; Minutat e Vizitës në UET; E.12.1; E.12.2; E.12.5; E.33; E.3.1; E.3.2; E.5.a; E.5.b; E.19).</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Ky program studimi është në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamentit të Shkencave Juridike, përgjegjëse për programin e studimit "E drejtë publike dhe ndërkombëtare" me dy profilet "E drejtë penale" dhe "E drejtë publike dhe kushtetuese". Ashtu siç u rekomandua edhe në standartin më sipër, ky program studimi duhet që në të ardhmen të riorganizohet, në mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor. Po ashtu, ky riorganizimi do të bëjë të mundur që të plotësohet karakteri i tij ndërdisiplinor.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në funksion të hartimit, monitorimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit ka realizuar ndarjen e detyrave mes njërive të IAL, të paraqitura dhe në organigramën e përditësuar të organizimit të Universitetit UET, që përcaktohet nga institucioni në aktet rregullore dhe udhëzuese të tij . IAL ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Dokumentet rregullatorë, si Statuti i Universitetit (neni 20), Rregulloret, përcaktojnë dhe sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, analizën dhe vlerësimin e vazhdueshëm. Organet kryesore dhe personeli akademik kanë mbështetjen e plotë nga</p>

	<p>struktura administrative e institucionit dhe vlerësimi i punës bëhet rregullisht si nga përgjegjësi i Departamentit edhe nga burimet njerëzore. Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar një mënyrë të garantuar për të pasur marrëdhënie eficiente bashkëpunimi midis tyre në vazhdimësi. (E.2; E.5; E.7; E.3.1; E.6)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dosje, dhe pas vizitës në institucion, rezulton se UET ka marrëveshje me IAL vendase dhe të huaja. Po ashtu, UET, por edhe njësi kryesore ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave dhe mundësive të tjera bashkëpunimi. Vërehet se, prej këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi janë krijuar lidhje konkrete ndërmjet universitetit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit.</p> <p>(E.32; E.34; E.34.1-34.27; E.35; E.4.a-4.d; E.5.a; E.5.b; E.19; E.12.5)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.</p>	<p>Në vijim të vlerësimit të kriterit nr. 2, vlerësojmë se, pavarësisht numrit të lartë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, do të sygjeronim rritjen e numrit të marrëveshjeve në nivel fakulteti dhe departamenti.</p> <p>(E.34.4; E.34.5; E.34.6; E.34.7)</p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, në fund të çdo viti akademik, në UET praktikat vlerësohen nga një komision i posaçëm dhe nga vetë studentët me anë të një formulari, ku merret një feedback për efektshmërinë e realizimit të tyre, dhe ku mund të punohet më tej në përmirësimin e praktikave.</p> <p><b>(E.32.1; E.32.2; E.34; E.35; E.54.10; B-I-3)</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET ka marrëveshje me IAL vendase dhe të huaja. Po ashtu, UET, por edhe njësia kryesore ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme për zhvillimin e praktikave dhe mundësive të tjera bashkëpunimi. Vërehet se, prej këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi janë krijuar lidhje konkrete ndërmjet universitetit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Në vijim të vlerësimit, vlerësojmë se, pavarësisht numrit të lartë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka lidhur UET, do të sygjeronim rritjen e numrit të marrëveshjeve në nivel fakulteti dhe departamenti.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

### Standardi II.1


**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit në Master i Shkencave në “E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare” ka dy profile “E Drejtë Penale”, “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”. Ky program është i organizuar në lëndë e module të cilat janë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi ka kohëzgjatje normale prej 2 vite akademike dhe në secilin vit studenti duhet të grumbullojë 60 kredite ECTS. Ky program ofrohet në bazë semestrale (4 semestra) dhe modulesh. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A – ja deri te E – ja (bazuar në VKM nr. 41, datë 24.10.2018). Ndarja në kategoritë/disiplinat përkatëse, ngarkesa me ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse, për çdo semestër, përcaktohen hollësisht në Rregulloren e këtij programi studimi, planin mësimor dhe kurrikulën e tij. (E.7; E.14; E.14.2; E.14.4)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe realizohet konform objektivave të përcaktuar. Ai synon ta pajisë studentin me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve;</li> <li>Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar;</li> <li>Formim tematik dhe jopanonamik apo historik;</li> <li>Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor;</li> <li>Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit;</li> <li>Stazhe, internship në rreth 50 kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj;</li> <li>Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës;</li> <li>Diplomë me origjinalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit;</li> </ol> <p>Ky program studimi u jep studentëve njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe përgatitje për kërkimin e pavarur në një fushë brenda një specialiteti. (E.4; E.7, pika 3.3.1)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës</p>	<p>Pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi është dhe praktika profesionale/internship, e cila zhvillohet në vitin e dytë, semestri i dytë dhe ka 12 kredite ECTS (10% të ECTS total të programit të studimit). Në këtë program studimi, detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës kanë 18 kredite</p>

<p>profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>ECTS, që përbën 15 % e totalit të krediteve të këtij programi. Teza e diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një studimi me karakter teoriko-praktik e analitik, e që lidhet drejtpërdrejtë me formimin e marrë gjatë zhvillimit të programit të studimit. Në përfundim të diplomimit, studentit pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave. (E.7; E.14; E.14.2; E.14.4)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të</p>	<p>N/A</p>




<p>veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë,</p>	<p>Ky program studimi ofrohet me dy profile, dhe është rezultat i mënyrës së ndërtimit dhe organizimit të programeve MSH në këtë institucion, duke mbajtur në konsideratë edhe riorganizimin e tyre. <b>(E.39- A.III)</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në këtë program studimi “Master i shkencave” në “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare” me dy profile, UET ka propozuar kodin përkatës 72MS-0421-S, bazuar në VKM nr. 310, dt. 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL-të në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin Nr. 31, dt.15.11.2022 të MAS. <b>(E.31.1.; E.31.2; E.31.3)</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet vetëm nga UET.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare” ka dy profile “E Drejtë Penale”, “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”. Ky program ofrohet në gjuhën shqipe, është i organizuar në lëndë e module të cilat janë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p> <p><i>Programi ka kohëzgjatje normale prej 2 vite akademike dhe në fund studenti duhet të grumbullojë 120 kredite ECTS. Ky program ofrohet në bazë semestrale dhe modulesh. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi respektojnë</i></p>




	<i>kërkesat që burojnë nga VKM nr. 41, datë 24.10.2018. Ndarja në kategoritë/disiplinat përkatëse, ngarkesa me ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse, për çdo semestër, përcaktohen hollësisht në Rregulloren e këtij programi studimi, planin mësimor dhe kurrikulën e tij.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>			
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është njësi kryesore e UET-së, që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta apo të ndërthurura me profilet shoqërore të njohura dhe licensuara nga organet shtetërore kompetente. Ky fakultet ofron disa lloje programesh, në cikle të ndryhme të studimit, në përfundim të të cilave lëshohet diploma përkatëse për studentët që frekuentojnë këto programe.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është organizuar në 3 njësi bazë duke plotësuar kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave Juridike;</li> <li>2. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara;</li> <li>3. Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor;</li> </ol> <p>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (34 pedagogë PAE) dhe 14 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="576 1856 1388 1964"> <tr> <td><b>Kualifikimi i stafit</b></td> <td><b>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare</b></td> </tr> </table>	<b>Kualifikimi i stafit</b>	<b>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare</b>
<b>Kualifikimi i stafit</b>	<b>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare</b>		

	PAE	PAK
Prof.Dr	4	2
Prof.Asoc	4	1
Dr/PhD	11	7
Dr. proces	11	3
Msc	4	1
<b>Total</b>	<b>34</b>	<b>14</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>48</b>	

Rezultoni se çdo njësi bazë e Fakultetit plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor. Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Juridike, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	2	1	2	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	3	3	2	-	1	-	2	1	1	-
Dr./PhD.	7	6	5	4	7	3	6	4	5	6
Dr proc	-	-	-	-	-	2	-	-	-	3
Msc.	6	3	2	3	1	2	-	-	-	2
Magjistrat	-	1	-	-	-	-	-	-	1	-
<b>Totali</b>	<b>17</b>	<b>14</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>12</b>

(E.2, neni 14-15; Struktura organizative 2022-2023 aneksi i Statutit).

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik

Në programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare", studenti krahas seancave me ekspertë të ftuar në auditor kryen praktikë në një nga institucionet/subjektet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, nën mbikqyrjen nga pedagogu i caktuar në rolin e këshilluesit të karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës angazhohet nëpërmjet parapërgatitjes së studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e

/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë. <b>(E. 32.1).</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të vendimit, Nr. 36, date 14/04/2021, Fakulteti ka përcaktuar koordinatorin për programin MSH “E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”. Kordinatori i programit të studimit ndjek në vazhdimësi ecurinë e zhvillimit të programit, dhe raporton në mënyrë periodike tek Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Juridike. Ndër të tjera, ai shqyrton cilësinë e silabuseve të hartuara nga titullarët e lëndëve përpara miratimit të tyre, miraton temat e eseve dhe tezat e provimeve, ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale. <b>(E. 36; E.7, pika7).</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është njësi kryesore e UET-së, që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta apo të ndërthurura me profilet shoqërore të njohura dhe licensuara nga organet shtetërore kompetente.</i></p> <p><i>Departamenti i Shkencave Juridike është njësi bazë mësimore dhe kërkimore - shkencore në Fakultet, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e UET-së, dhe aktet e tjera rregullatore, që ka për detyrë të organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Mësimdhënia dhe aktiviteti kërkimor-shkencor ofrohen sipas standardeve të vendosura nga universiteti, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Departamenti i Shkencave Juridike është përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti/departamenti zotëron dhe disponon informacionet e nevojshme në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit MSH “E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, në përputhje me VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Këto të dhëna për këtë program studimi gjenden edhe në ‘Dokumenta UET’ dhe janë të aksesueshme nga stafi përmes platformës UET LMS, një sistem menaxhimi online të mësimdhënies me të gjitha funksionet e tij. Gjithashtu, të dhëna të nevojshme për këtë program studimi publikohen edhe në faqen web të universitetit: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a>. (E.4; E.7, E. 46.1).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Ky program studimi organizohet në lëndë/module, vlerësuar në kredite (ECTS), sipas planit mësimor të miratuar për këtë qëllim. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike; orë në auditor dhe jashtë auditorit.</p> <p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione e seminare për çdo kategori, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila prej tyre.</p> <p>Organizimi i veprimtarisë mësimore shtrihet në 4 (katër) semestra me kohëzgjatje normale 15 javë. Afati normal i studimeve për këtë program studimi është 2 (dy) vite akademike. Programet e lëndëve (syllabuset) hartohen sipas formatit të miratuar, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. Në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion programet dhe materialet për çdo lëndë që ofrohet. Pedagogu i lëndës vendos në sistemin LMS, syllabusin së bashku me leksionet, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar të lëndës. Përmes këtij sistemi studentët njoftohen për detyrat që pedagogu cakton, si edhe informohen për rezultatet e vlerësimit. Gjithashtu ata mund të komunikojnë me pedagogun e lëndës për çdo paqartësi apo pyetje. (E.7; E.14.2; E.14.4).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,</p>	<p>Rregullorja e këtij programi studimi MSH “E drejtë publike dhe ndërkombëtare” përmban parashikime në lidhje me pranimin në këtë program studimi, kriteret për pranim, procedurën e transferimit dhe rregullat që lidhen me transferimin e studimeve si dhe ekuivalentimet. Studentëve të regjistruar në këtë program studimi mund t’u njihen kredite të fituara në programe të tjera</p>

transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	studimi në fusha të njëjta ose të përafërta, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren përkatëse të transferimeve në UET. <b>(E.4; E.7, pika 9; E. 28).</b>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i është nënshtruar një procesi riorganizimi dhe është i strukturuar duke respektuar ndarjen mes lëndëve me detyrim (bazë dhe karakterizuese) dhe lëndët me zgjedhje, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Gjithsesi, siç u përmend edhe më sipër në Fushën 1, duhet të rishikohet ky program studimi në mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor.  Për t'u diplomuar në këtë program studimi, studenti duhet të fitojë 120 ECTS nga përmbushja e të gjithë komponentëve akademikë të programit. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacion i detajuar për secilën nga rubrikat e syllabusit. Në syllabus gjejmë pasqyrim të dhëna të tilla si: përshkrim i kursit, objektivat e tij, kreditet ECTS dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/javë, temat që trajtohe në lëndë, kriteret e vlerësimit, pjesëmarrjen dhe angazhimin, literaturën bazë dhe të rekomanduar, etj. Syllabuset e hartuara nga pedagogu/ët e lëndës duhet të marrin edhe miratimin e përgjegjës të departamentit. Këto syllabuse janë në dispozicion të studentëve të cilët mund t'i aksesojnë përmes sistemit LMS (Learning Management System). Syllabuset e lëndëve të programit të studimit janë pjesë e dosjes me dokumentacionin mbështetës që shoqëron këtë raport. <b>(E.4; E.14; E.14.2; E.19; E.39- A.III).</b>
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programet e lëndëve dhe materialet që vihen në dispozicion, rishikohen para fillimit të vitit akademik dhe bëhen ndryshimet dhe përditësimet e nevojshme në fushën juridike. Ndryshime të tilla synojnë të tregojnë rritje e fundit në disiplinë, ndryshimet në legjislacion, jurisprudencë dhe kërkimin shkencor. Këto ndryshime miratohen nga grupet mësimore-kërkimore dhe depozitohen e ruhen në departament. <b>(E.7; E.14; E.19; E.39- A.III).</b>
<b>Konkluzione</b>	<i>Fakulteti/departamenti zotëron dhe disponon informacionet e nevojshme në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit MSH "E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare", në përputhje me VKM nr.41, datë 24.01.2018</i>






	<p><i>“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Ky program studimi organizohet në lëndë/module, vlerësuar në kredite (ECTS), sipas planit mësimor të miratuar për këtë qëllim. Rregulla më të hollësishme parashikohen në rregulloren e këtij program studimi dhe dokumenta të tjerë institucionalë. Programi i është nënshtruar një procesi riorganizimi dhe është i strukturuar duke respektuar ndarjen mes lëndëve me detyrim (bazë dhe karakterizuese) dhe lëndët me zgjedhje, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Gjithsesi, siç u përmend edhe më sipër në Fushën 1, duhet të rishikohet ky program studimi në mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Ndarja në kategori e veprimtarive formuese, shpërndarja e lëndëve mundëson njohuritë dhe aftësitë e nevojshme mundësojnë aftësi të nevojshme për punësimin e tyre apo edhe për të vijuar studimet në ciklin e tretë të studimeve. Në këtë program studimi, studenti merr njohuri dhe aftësi me qëllim orientimin e tij praktik, duke iu përshtatur gjithnjë e më shumë zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë dhe zhvillimit të vendit/tregut të punës. Departamenti, përmes këtij programi studimi, synon ofrimin në tregun e punës të profesionistëve të aftë dhe të pajisur me njohuritë më të përditësuara jo vetëm nga ana teorike, por me një vëmendje të veçantë në aspektet praktike dhe analitike. (E.4; E.7; E.14)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore</p>	<p>Hartimi i këtij programi studimi është bërë duke marrë parasysh faktin që të jetë në përputhje me qëllimin/objektivat e programit, me kriteret dhe detyrimet për këtë program, si program i ofruar në ciklin e dytë të studimeve MSH, sipas përcaktimeve ligjore</p>

<p>mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>dhe akteve të brendshme rregullatore të UET-së, për arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit. Ky program studimi është ndërtuar për t'iu përshtatur ndryshimeve dhe zhvillimeve në fushën e arsimit të lartë, për vijimin e mëtejshëm të studimeve në programe të ciklit të tretë dhe formimit/aftësimin profesional.</p> <p>Referuar planit mësimor të këtij programi studimi, shpërndarja e lëndëve në semestra është bërë duke patur parasysh kriterin kronologjik dhe shkallën e vështirësisë së konceptimit të tyre si edhe hierarkinë e formimit të koncepteve dhe lidhjen e lëndëve/moduleve me njëra-tjetrën. Lëndët e kategorive A dhe B që përbëjnë pjesën kryesore të formimit teorik e profesional të studentit e që kapin së bashku 72 ECTS (60 % të totalit të krediteve për këtë program studimi) janë konceptuar me më shumë kredite sesa lëndët me ndërdisiplinare/të profilit (gjë që reflektohet në kreditet e lëndëve dhe raportin leksion/seminar dhe orë jashtë auditorit). Kjo për të ndërtuar një raport më të drejtë mes lëndëve të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje, të ndara në kategoritë respektive (A-E). Raportet leksion/seminar për secilën lëndë mundësojnë realizimin e objektivave të menduarit kritik dhe i ndihmon studentët në formimin e tyre për diplomën përkatëse MSH si dhe në tregun e punës.</p> <p><b>(E.7; E.14; E.14.2; E.14.4; Aneks RVB- Tabelat përmbledhëse).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë MSH “E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, është hartuar duke mbajtur parasysh përcaktimet në lidhje me strukturën e këtij programi sipas kriterëve të vendosura nga VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; si dhe në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera të UET-së.</p> <p>Ai është konceptuar dhe orientuar bazuar në nevojën për përgatitjen e specialistëve të aftë për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të tregut të punës në fushën e të drejtës publike dhe ndërkombëtare. Përsa i takon profileve, konstatohet se aktualisht dy profilet: ‘E drejtë penale’ dhe ‘E drejtë publike dhe kushtetuese’ janë përshtatur me riorganizimin e bërë për këtë program studimi në tërësi, pas heqjes së profilit të tretë.</p>

	<b>(E.14; E.14.1; E.14.4; Aneks RVB- Tabelat përmbledhëse).</b>
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Për hartimin e këtij programi studimi sipas kriterëve/kërkesave ligjore, janë mbajtur parasysh nevojat për kombinim të aspektit teorik më atë praktik, për të arritur objektivat e programit. Konceptimi dhe ndarja mes veprimtarive formuese synon që studentët të kenë mundësi mobiliteti dhe transferimi studimesh, të konkurrojnë dhe të përshtaten denjësisht jo vetëm në kushtet e tregut vendas, por edhe më gjerë, siç përcaktohet edhe në dokumentat e hartuar nga UET dhe aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>Përmes njohurive që jepen në lëndë sipas ndarjes në veprimtari të ndryshme formuese, synohet ofrimi në tregun e punës të profesionistëve të aftë dhe të pajisur me njohuritë më të përditësuara jo vetëm nga ana teorike, por me një vëmendje të veçantë në aspektet praktike dhe analitike. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e profesionistëve të aftë në fushën juridike si dhe aftësimi i studentëve për të qënë sa më kompetitivë në të ardhmen në ndjekjen e studimeve jashtë vendit, në pjesëmarrjen në projekte të ndryshme shkëmbimi, si dhe për të hedhur bazat në përgatitjen e ekspertëve të së drejtës publike, në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p><b>(E.7; E.14-14.4; Aneks RVB- Tabelat përmbledhëse).</b></p>
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Çdo lëndë e këtij programi ka syllabusin e saj. Titullari i lëndës ka detyrimin të hartojë në kohën e duhur, programin mësimor të lëndës (syllabus) në përputhje me planin mësimor, një kopje e të cilit dorëzohet në Departament, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohet/firmoset nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Syllabuset përditësohen vazhdimisht mbi bazën e nevojave dhe zhvillimeve në fushë, mbi bazën e propozimeve të titullarit të lëndës dhe diskutimeve në nivel departamenti. Departamenti bën përpjekje për të pasuruar literaturën që u ofrohet në syllabuset e lëndëve studentëve të këtij programi studimi. Kështu rezulton se syllabuset përmbajnë literaturë që freskohet herë pas here dhe e përditësuar me botime të reja në fushë (si rregull, jo më të vjetra se 5 vitet e fundit). <b>(E.19; E.39- A.III)</b></p>
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit	Përmes këtij programi studimi, studentët pajisen me kompetenca teorike dhe praktike, me dije e aftësi, njohuritë e nevojshme në

27

<p>garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>fushën juridike, që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij, për kualifikimin e nevojshëm dhe specializimin në fushë, dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Organizimi i këtij programi është bërë mbi bazën e objektivave institucionale, duke mbështetur misionin e UET për një edukim cilësor dhe forcimit të dijeve të qëndrueshme.</p> <p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për lëndën përkatëse: emërtimi dhe kreditet e lëndës, titullari/asistenti (nëse ka), viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore, rezultatet e të nxënit, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit lënda, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar, etj. (E.4; E.7; E.19; E.39- A.III)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Ky program synon që të mundësojë një ofertë akademike nxitëse dhe konkurruese, që ofron mundësi për studentët të thellojnë dijet dhe kualifikohen më tej në fushën juridike (e drejtë publike dhe ndërkombëtare). Qëllimi është përgatitja e studuesve dhe profesionistëve, në përgjigje të dinamikave dhe nevojave të tregut, përmes një filozofie bashkëkohore që ka në thelb vlerat dhe parimet në përputhje me Strategjinë e UET-së. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e profesionistëve të aftë në fushën juridike si dhe aftësimi i studentëve për të qënë sa më kompetitivë në tregun e punës, në ndjekjen e studimeve jashtë vendit, në pjesëmarrjen në projekte të ndryshme shkëmbimi, si dhe i mundëson studentëve të vijnë më tej në ciklin e tretë të studimeve. (E.3.3; E.4; E.7; E.12.5).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ndarja në kategori e veprimtarive formuese, shpërndarja e lëndëve mundëson njohuritë dhe aftësitë e nevojshme mundësojnë aftësi të nevojshme për punësimin e tyre apo edhe për të vijuar studimet në ciklin e tretë të studimeve.</i></p> <p><i>Departamenti, përmes këtij programi studimi, synon ofrimin në tregun e punës të profesionistëve të aftë dhe të pajisur me</i></p>

	<i>njohuritë më të përditësuara jo vetëm nga ana teorike, por me një vëmendje të veçantë në aspektet praktike dhe analitike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Fakulteti dhe Departamenti kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm me institucione të ndryshme, si pjesë e politikës së institucionit për të forcuar bashkëpunimin, duke lidhur mësimdhënien me praktikën. Për të përshtatur kurrikulën universitare, Departamenti ndjek nga afër politikat arsimore të hartuara nga MAS, nevoja për të diplomuar specialistë të fushës juridike, gjithnjë në përputhje me trendin e zhvillimit në përputhje me tregun e punës. Ndryshimet e mundshme në kurrikulën e këtij programi studimi janë pjesë e debateve në nivel departamenti, në mbledhje të tij, dhe pasqyrojnë filozofinë e departamentit për t'u ofruar studentëve marrjen e ekspertizës më të mirë të profesorëve që aktivizohen në këtë program studimi; të përgatisë specialistë të aftë profesionalisht, në gjendje t'i përgjigjen nivelit bashkëkohor të zhvillimit; ju ofron studentëve fleksibilitet në njohuritë e përfituara, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë interesat e tyre të specializuara në një gamë të gjerë fushash dhe hapësirash. Bazuar në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës dhe studentëve, institucioni programon politika dhe ndërmer masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik  (E.2, neni 30; E.3.3; E.4; E.12.1; E. 12.5).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e	UET synon përfshirjen në rritje të studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit, në veprimtari akademike dhe në kërkimin shkencor, në konferenca dhe trajnime/seminare, etj.

<p>tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu, pranë departamentit funksionon dhe Bordi i Tregut të Punës krijuar me anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë punësuar. Një here në muaj, Departamenti zhvillon mbledhje të hapur për studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit e më gjerë. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga UET dhe vazhdon të jetë prioriteti i Planit Strategjik 2021-2025. (E.2, neni 30.4; E.3.3; E.12.1)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Referuar takimeve në institucion, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik. Në synimet e këtij programi është intensifikimi i bashkëpunimit institucional me aktorët dhe institucionet e angazhuara sikurse dhe zgjerimi i këtij rrjeti. (E.3.3; E.4; E.12.1; E.12.5; E.38).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Fakulteti dhe Departamenti kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm me institucione të ndryshme, si pjesë e politikës së institucionit për të lidhur mësimdhënien me praktikën. Ndryshimet e mundshme në kurrikulën e këtij programi studimi janë pjesë e debateve në nivel departamenti, në mbledhje të tij, dhe pasqyrojnë filozofinë e departamentit për t'u ofruar studentëve marrjen e ekspertizës më të mirë të profesorëve që aktivizohen në këtë program studimi. Institucioni ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, në bashkëpunim me studentët dhe Bordin e Tregut të Punës, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik. Në studimin e tregut të punës për këtë program studimi përcaktohet ndër të tjera se për të mundësuar arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve, programi i studimit ofron një ndërthurje midis formimit teorik dhe praktik, duke u bazuar edhe në praktikat më</i></p>

	<i>të mira të universiteteve të huaja. Por as në dokumentat e vëna në dispozicion dhe as gjatë vizitës në institucion nuk na u dha ndonjë shembull i një modeli të tillë të huaj ku është bazuar ky program me profilet përkatëse, pas rishikimit të tij nga 3 në dy profile dhe përmajtjen e kurrikulës respektive.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Ky program ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike, me kohëzgjatje normale prej 2 vitesh studimi (120 ECTS). Ky program synon të përgatisë studentët që të kenë mundësi për karriere profesionale dhe profil akademik në të drejtën publike dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ky program ofron mundësi për vijimin e studimeve në ciklin e tretë dhe kërkim shkencor. Kjo shprehet në objektivat kryesore të programit në përputhje me strategjinë kërkimore të UET-së. UET ka objektiva të përcaktuara qartë përsa i përket kërkimit shkencor, duke orientuar dhe nxitur vazhdimisht studentet e tij në këtë drejtim. (E.7, neni 3.3; E.3.2; E.4).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Fakulteti dhe departamenti kompetent respekton dhe garanton lirinë akademike në mësimdhënie, mësimnxënie, në kërkimin shkencor dhe inovacion. Në fillim të çdo viti akademik, shpërndarja e lëndëve dhe e ngarkesës bëhet në bazë të objektivave të përcaktuara nga departamenti në përputhje me detyrimet e personelit akademik për kërkimin shkencor. Përdoren disa mekanizma për ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve të tjera. UET gjatë gjithë vitit akademik zhvillon aktivitete të ndryshme si p.sh. Forumet me të ftuar personalitete të fushave të ndryshme. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe Konferenca e përvitshme e DSSH (Ditët e Studimeve Shqiptare) ku pedagogët marrin pjesë me punimet e tyre shkencore. (E. 3.2, pika 10 dhe 11; E.55).

<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit nxit dhe motivon studentët të përfshihen në projekte apo studime. Kështu p.sh detyra e kursit/eseja është një mundësi që studentët kanë të angazhohen në lëndë në këto veprimtari. Po ashtu, në aktivitetet e ndryshme si: forume me lektorë të ftuar, konferenca shkencore që zhvillohen etj, studentët ftohen të marrin pjesë. UET cdo vit, realizon Konferencën Ndërkombëtare “Ditët e studimit Shqiptar” dhe “Ditët e studimit Shqiptar” Junior dhe nxit studentët të marrin pjesë në to apo edhe të prezantojnë punimet e tyre. (E. 3.2; E.55).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike në realizimin e disa aktiviteteve akademike e kërkimore mbështetet nga institucioni financiarisht. Kjo mbështetje financiare, ka të bëjë me hulumtimin/kërkimin, pjesëmarrjen në konferenca, dhe aktivitete të tjera shkencore të stafit akademik, botimin e në revistën e fakultetit “Ius and Iusticia”. Në fund të vitit, vlerësimi individual bëhet duke reflektuar edhe realizimin e aktivitetit kërkimor, përveç atij akademik. Në formularin e vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik, një pjesë e konsiderueshme reflekton realizimin e aktivitetit kërkimor e botues të stafit akademik. Institucioni zbaton edhe konceptin e grantit kërkimor për pedagogët, që mbështeten për aktivitet kërkimor dhe botues të një niveli të caktuar. Gjatë vizitës në institucion, <i>GVJ u informua se për të përftuar këtë grant ishte e vështirë dhe nga personat që kontaktuam nuk morëm ndonjë informacion se sa persona nga stafi akademik e kishin përftuar këtë mbështetje financiare në 2-3 vitet e fundit.</i></p> <p>Rol më rëndësi luan në këtë drejtim edhe bashkëpunimi me Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve (ZPP), e cila ndihmon në rritjen e misionit akademik dhe kërkimor të Universitetit duke i ofruar shërbim dhe mbështetje administratës së Universitetit, fakulteteve, dhe stafit për të siguruar dhe për të menaxhuar financim të jashtëm për aktivitetet të Universitetit. Në dokumentat e vënë në dispozicion, nuk del e qartë cilat janë projektet ku përfshihet Departamenti i Shkencave Juridike që mbulon programin e studimit “E drejtë publike dhe ndërkombëtare” dhe për këtë duhet të ishin paraqitur të dhëna më të detajuara. Po ashtu, evidence e vënë në dispozicion për projektet UET, ajo përfshin periudhën 2014-2020 dhe nuk ka info.për tre vitet në vijim 2020-2023, duke e bërë informacionin të pa përditësuar. Edhe gjatë vizitës në UET, GVJ nuk mori dot info.më tepër në</p>



	<p>lidhje me projektet aktuale ku departamenti është përfshirë nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve.</p> <p><b>(E.28.1; E.41; E.3.2/dok.shtesë, C.IV; Minutat e vizitës në UET)</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit përcakton prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat e institucionit. Për realizimin e këtyre aktiviteteve, fakulteti / departamenti angazhon stafin akademik të këtij program por edhe studentët. Në lidhje me mbështetjen financiare që ofrohet, <u>GVJ vlerëson se UET duhet të ofrojë një mbështetje më të mirë në lidhje me financimin e aktiviteteve kërkimore e botuese të stafit akademik dhe pjesëmarrje më të madhe në projekte kërkimore. Edhe gjatë vizitës në UET, GVJ nuk mori dot info.më tepër në lidhje me projektet aktuale ku departamenti është përfshirë nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve.</u></i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.7

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Institucioni ofron mundësi dhe hapësirë për stafin akademik në punën kërkimore, aktivitetin akademik të tyre si dhe për vlerësimin e performancës dhe progresin e bërë në këtë drejtim. Kjo merr rëndësi në kushtet e konkurrencës dhe për t'iu përgjigjur sfidave për institucione që ofrojnë arsim dhe kërkim sa më cilësor dhe në shërbim të interesave të vendit dhe shoqërisë. Aktualisht ka një pjesëmarrje në rritje të partneriteteve dhe bashkëpunimit me aktorë të tjerë për aktivitete, studime, apo forma të tjera bashkëpunimi me interes, si dhe pjesëmarrje më e madhe për t'u angazhuar në kërkime bashkëpunuese ndërkombëtare. Drejtimi i kërkimit shkencor, realizohet nga Fakultetet dhe Departamentet. Projektet e mëdha kërkimore kanë karakter multidisiplinar dhe grupet kërkimore kanë si qëllim përmbushjen e objektivave të</p>

	PMK-së dhe janë në koherencë me akset kërkimore individuale të kërkuesve shkencor të përfshirë në to. (E. 3.3; E.4; E.28.1).
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor- shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Në programet që ofron UET me synimin për krijimin e një gjenerate të re profesionistësh dhe kërkuesish, i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes së tyre në aktivitete e veprimtari akademike e kërkimore, duke u angazhuar në projekte të kombëtare e ndërkombëtare dhe inkurajon bashkëveprimin me aktorë të tjerë të interesuar në këtë fushë. Gjithashtu është rritur edhe shkalla e bashkëpunimit me institucione të tjera vendase apo të huaja. Në këto aktivitete janë përfshirë personeli akademik dhe studentët. Këtu vlen të theksohen edhe grupet drejtuese të PMK-ve si një mekanizëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë së produktit shkencor si dhe për orientim më të mirë të studentëve doktoralë. (E.4; E.17; E.28.1).
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Gjatë vitit akademik institucioni ka zhvilluar një sërë aktiviteteve si: konferenca, leksione të hapura, trajnime, seminare, forume, me të ftuar vendas apo të huaj personalitete në fushë, ku në to kanë marrë pjesë edhe stafi akademik dhe studentët të këtij program studimi. Të gjitha këto i shërbejnë aftësisë më të mirë të studentëve dhe përgatitjes profesionale të studentëve për një qasje sa më të mirë në tregun e punës dhe kërkesat e tij. Këto aktivitete rrisin mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave, forcojnë kontaktet dhe rrisin mundësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë në projekte dhe aktivitete lokale dhe/ose ndërkombëtare, e duke ndihmuar kështu personelin akademik dhe studentët për arritjen e objektivave të formimit për këtë program studimi.  UET synon përfshirjen në rritje të studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit, në veprimtari akademike dhe në kërkimin shkencor, në konferenca dhe trajnime/seminare, etj. Gjithashtu, pranë departamentit funksionon dhe Bordi i Tregut të Punës krijuar me anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë punësuar. Një here në muaj, Departamenti zhvillon mbledhje të hapur për studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit e më gjerë. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë

	të vazhdueshme nga UET dhe vazhdon të jetë prioriteti i Planit Strategjik 2021-2025. (E.2, neni 30.4; E.3.3; E.12.1)
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Ky program studimi synon që t'i japë studentit dhe ta pajisë atë me njohuri të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën juridike, që të jenë konkurrentë të denjë në tregun e punës, qoftë vendas apo të huaj. Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me prioritetet e UET dhe strategjitë e tij zhvillimore dhe synon përshtatjen e programit të studimit me nevojat e tregut të punës. (E.4; E.7; E.17).
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Bazuar në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës dhe studentëve, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik. Departamenti mban parasysh kërkesat për të aplikuar për profesione të caktuara ligjore si: avokat, noter, magjistrat, etj. duke përshtatur kurrikulën me kompetencat e nevojshme profesionale. (E.3.3; E.4; E.12.1; E.38).
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Programi i studimit Master i Shkencave në "E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare" është bazuar në aktet ligjore në fuqi, Kartën e Bolonjës dhe është konceptuar bazuar në sistemin ECTS të krediteve. Kjo i jep mundësi studentëve të transferojnë studime apo të njohin kreditet e fituara në këtë program studimi. Ky program studimi është pjesë e programeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në UET, i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. (E.5; E.4; E.7).
<b>Konkluzione</b>	<i>Në programet që ofron UET i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes së tyre në aktivitete e veprimtari akademike e kërkimore, duke u angazhuar në projekte të kombëtare e ndërkombëtare dhe inkurajon bashkëveprimin me aktorë të tjerë të interesuar në këtë fushë. Gjithashtu është rritur edhe shkalla e bashkëpunimit me institucione të tjera vendase apo të huaja. Në këto aktivitete janë përfshirë personeli akademik dhe studentët. Këtu vlen të theksohen edhe grupet drejtuese të PMK-ve si një mekanizëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë së produktit shkencor si dhe për orientim më të mirë të studentëve doktorale.</i>

	<i>Ajo që konstatohet lidhet me faktin që UET duhet të ofrojë një mbështetje më të mirë në lidhje me financimin e aktiviteteve kërkimore e botuese të stafit akademik dhe pjesëmarrje më të madhe në projekte kërkimore që lidhen me departamentin e shkencave juridike që mbulon programin e studimit MSH "E drejtë publike dhe ndërkombëtare".</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Mësimdhënia/mësimnxënia dhe transmetimi i dijeve përfshin mënyra/forma të ndryshme të aplikuara si: eksione, seminare, leksion/seminare, punë laboratorike, praktika mësimore, detyra praktike, detyra kursi, orë të hapura, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe me punim diplome. Kreditet e çdo lënde mbajnë parasysht ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore pune të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit). Po ashtu, janë organizuar edhe leksione të hapura, ku ftohen studiues apo profesionistë të

	ndryshëm vendas apo të huaj për tema të caktuara dhe me interes për studentët e fushës. Mësimdhënia/mësimnxënia rregullohen në mënyrë të detajuar në Rregulloren e UET-së dhe Rregulloren e Programit të Studimit. (E.5; E.7; E.39)
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik në lidhje me mësimdhënien respekton rregullat e institucionit, mbi mënyrën e zhvillimit të orës së mësimi, vlerësimin e studentëve, literaturën dhe materialet që u ofrohen atyre, etj. Duke qenë se çdo lëndë ka specifikat e saj, dhe kështu pedagogu zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies, të aktivizimit të studentëve, duke kombinuar aspektin teorik me atë praktik e kazustik, etj. Programi i lëndës (syllabusi) përmban detyrimet që duhet të përmbushë studenti përgjatë kursit dhe format/metodologjinë e mësimdhënies. (E.14.2; E.19; E. 39).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UET mbështet personelin akademik në aspektin didaktik dhe teknologjinë që faciliton procesin mësimor. Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, Departamenti i Shkencave Juridike (DSHJ) vlerëson si prioritet mbështetjen e stafit akademik të programit të studimit, në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm të tyre me qëllim përmirësimin e cilësisë. Në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe specifikat e tij, institucioni mundëson përdorimin e metodave të përshatshme të zhvillimit të mësimi në lëndë, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe objektivat formues të programit të studimit MSH “E drejtë publike dhe ndërkombëtare”. Gjithashtu, UET si traditë zhvillon në mënyrë periodike Staff Development Day/Ditën e Zhvillimit të Stafit, një praktikë që synon trajnimin e stafit në lidhje me aspektin profesional të mësimdhënies dhe metodologjinë e përdorur, projektet, etj. Po ashtu, organizohen edhe trajnime me sfain për përdorimin e teknologjisë së informacionit në raport me mësimdhënien dhe procesin akademik, si p.sh. trajnime mbi përdorimin e sistemit LMS. Realizimi i objektivave të programit përkon me objektivat strategjike të universitetit. Ai mbështetet nga një infrastrukturë cilësore në procesin e mësimdhënies dhe në mjediset e tjera mbështetës.(E.4; E.17; E.39; E.46.4).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në	Stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi, ka kualifikimet dhe eksperiencën akademike të nevojshme por

<p>mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>edhe përvojë profesionale në fushë dhe përdor metoda mësimdhënie interaktive që nxisin debatin dhe të menduarin kritik nga ana e studentëve. Duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe çdo lëndë të tij mësimdhënia në lëndët e këtij program studimi është një kombinim i metodës tradicionale me ato inovative duke përfshirë dhe pëdorimin e teknologjisë (prezantime me videoprojektor, ppt, foni në salla të caktuara, etj), gjithmonë në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këtë, GVJ e konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion në auditorë të leksioneve/seminareve. Marrëdhënia mes pedagogëve dhe studentëve respekton rregullat e komunikimit dhe etikës institucionale. (E.19; E.20; E.39; Minutat e vizitës në institucion).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>UET e ka pjesë të strategjisë së tij përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës universitare dhe rritjes së cilësisë. DSHJ vlerëson si prioritet realizimin e procesit mësimor me metodat me inovative për përvetësimin sa më të mirë të njohurive nga ana e studenteve. Përmes tërheqjes së mendimit të studentëve nga përfaqësimi i tyre në organet/struktura të ndryshme të tij, apo nga të dhënat e mbledhura nga pyetsori dhe vlerësimet e studentëve institucioni dhe departamenti vlerëson dhe përpiqet të adresojë kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>(E.3.3; E.4; E.17).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin</p>	<p>UET ka ngritur tashmë strukturat në nivel institucional që merren me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë, ku ky sistem i sigurimit të brendshëm të cilësisë ka në qendër KSBC në nivel institucional, i cili bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë/strukturat e tjera që merren me sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Institucioni dhe departamenti, mbështesin metodat e reja dhe inovative në mësimdhënie. Siç u shpreh edhe më sipër, pedagogët e këtij programi përdornin metoda mësimdhënie atraktive për studentët, ku këtu vjen në ndihmë edhe teknologjia. Pavarësisht sfidave në përdorimin e këtyre metodave të reja, por falë manualeve informative dhe mbështetjes së dhënë edhe nga specialistët e IT-së në</p>

dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	institucion, është bërë e mundur që këto mënyra inovatore të jenë pjesë e mësimdhënies për të gjithë stafin akademik. <b>(E.2, neni 16; E.4; E.30.1; E.46.4).</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>UET garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktika bashkëkohore, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Institucioni dhe departamenti, mbështesin metodat e reja dhe inovative në mësimdhënie; pedagogët e këtij programi përdornin metoda mësimdhënie atraktive për studentët, ku këtu vjen në ndihmë edhe teknologjia. Përmes tërheqjes së mendimit të studentëve nga përfaqësimi i tyre në organet/struktura të ndryshme të tij, apo nga të dhënat e mbledhura nga pyetori dhe vlerësimet e studentëve institucioni dhe departamenti vlerëson dhe përpiqet të adresojë kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e UET-së, Kreu V me titull ‘Kontrolli dhe vlerësimi i dijes’, si dhe në Rregulloren e programit të studimit, pika 5 ‘Verifikimi i dijeve të fituara nga studentët’ si edhe me dokument të veçantë, pjesë e Broshurës së Dokumenteve. Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse dhe pasqyrohen edhe në syllabuset e lëndëve. <b>(E.5; E.7; E.7.2).</b>

<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të semestrit, studentëve iu vihen në dispozicion syllabuset për çdo lëndë që ndjekin. Çdo pedagog në fillim të lëndës i njeh studentët me përmbajtjen e syllabusit, me informacionin e nevojshëm që përmban syllabusi: emërtimi dhe kreditet e lëndës, pedagogun/pedagogët e lëndës, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit parashikon informacionin e duhur për vlerësimin në lëndë dhe format e kontrollit të dijeve. Pedagogu i lëndës vendos në sistemin LMS, syllabusin së bashku me leksionet, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar të lëndës. Përmes këtij sistemi studentët njoftohen për detyrat që pedagogu cakton, si edhe informohen për rezultatet e vlerësimit. (E.7; E.19).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi është i vazhdueshëm dhe përbëhet nga disa komponentë: testime me shkrim e me gojë, detyra kursi, prezantime, etj dhe si detyrim përmbyllës është teza e diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit MSH. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Vlerësimi i studentëve ka natyrë stimuluese dhe jo penalizuese. Ai synon të tregojë se çfarë di studentit dhe çfarë duhet të mësojë më shumë. Për këtë qëllim çdo vlerësim i pedagogut duhet të shoqërohet me shpjegimin përkatës. Për lëndët e tipologjisë 2 (të gjitha lëndët e këtij programi studimi janë të tipologjisë 2)- ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohet me 10% të vlerës së pikëve totale dhe 20 % detyra e kursit, testimet gjatë vitit kanë 30% të vlerës së pikëve totale dhe provimi përfundimtar ka vlerën 40% të pikëve totale. (E.7; E.7.2; E.19; Aneks RVB- Tabela nr.15).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e UET-së, në Rregulloren e programit të studimit, si edhe me dokument të veçantë, pjesë e Broshurës së Dokumenteve. Kriteret dhe</i></p>



	<p><i>mënyra e testimit të njohurive u njoftohen studentëve gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), por edhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse dhe pasqyrohen edhe në syllabuset e lëndëve. Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi është i vazhdueshëm dhe përbëhet nga disa komponentë. Si detyrim përmbyllës është teza e diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit MSH.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Siç u përmend më sipër, testimi dhe vlerësimi në lëndë, realizohet gjatë gjithë vitit akademik (vlerësimi i vazhduar), duke dhënë në fund rezultatin/notën përfundimtare. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e provimit, detyrave, laboratoreve në vlerësimin përfundimtar, literatura, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj., përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhen te ditura studentëve që ndjekin lëndën. Teza e provimit hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Shkalla e përvetësimit të dijeve vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash nga 4 në 10, dhe me pikë nga 0-100, si dhe shprehet me gërma nga F në A. Nota kaluese më e ulët është nota pesë dhe më e larta është dhjetë; gërmat nga E në A janë kaluese. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve, ku këto elementë kanë përlogaritjet përkatëse bazuar në tipologjinë e lëndës (tipologjia 1 dhe 2).</p> <p><b>(E.5, Kreu V; E.7, pika 5; E.7.2; E.19).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të</p>	<p>Sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë si dhe në të gjitha ato raste kur</p>

<p>testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>kjo ka qenë e mundur në varësi të natyrës së lëndës. Sistemi teams LMS që UET aplikon lehtëson informacionin për efekte të detyrimeve të studentit në lëndë, përfshirë edhe vlerësimet e ndryshme. Kjo mënyrë rrit transparencën dhe ul subjektivizmin dhe format abuzimi të ndryshme. Ajo e bën vlerësimin më objektiv dhe më të shpejtë në kohë. (E.46-E.46.4)</p>
<p><b>Kriteri 3. Vlerësimi</b> përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës kryet në përputhje me syllabusin, formati i të cilit është miratuar sipas parametrave që burojnë nga aktet në fuqi. Programet e lëndëve (syllabuset) hartohen sipas formatit të miratuar, konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet edhe mënyra dhe sistemi i vlerësimit. Si për lëndët e tipologjisë 1 ashtu edhe të tipologjisë 2, vlerësimi përbëhet nga disa kriteret, ku provimi përfundimtar zë 40 % të vlerësimit total në lëndë. Mënyra e vlerësimit përcaktohet dhe në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi, në pjesën 'forma e kontrollit të dijeve'. Po ashtu, institucioni ka të miratuar edhe formatin e tezës së provimit përfundimtar me rubrikat përkatëse. (E.7; E.7.2; E.7.3; E.19).</p>
<p><b>Kriteri 4. Vlerësimi i</b> njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimi i ndërmjetëm, provimi përfundimtar, detyrat e kursit/eseja, detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka bërë korigjimin dhe në procesverbalin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Teza e provimit në fund ka edhe një rubrikë 'Komente të pedagogut rreth përgjigjes së studentit për pyetjen e kategorisë C "Mbaj qëndrimin tënd"'. (E.7; E.7.2; E.7.3).</p>
<p><b>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse</b> dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Rregullorja e UET parashikon rregulla për zhvillimin e provimeve, ndalimin e kopjimit dhe të plagjiaturës. Plagjatura në rastin e esesë dhe të diplomës vlerësohet me notën jokaluase (4) si notë përfundimtare në lëndë. Kopjimi gjatë provimit apo komunikimi me studentë të tjerë sjell ndërprerjen e provimit për studentin që shkell rregullat e korrektesës në provim, dhe po ashtu studentin vlerësohet me notën 4 (jokaluase). Nëse këto lëto</p>

	shkelje janë të përsëritura nga studenti, merren masa suipas rregullave të etikës që institucioni aplikon (Kodi i Etikës), dhe nëse ndodh për herë të tretë, kjo çon në përjashtimin nga programi i studimit të UET-së. (E.5, neni 33; E.16).
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Si rregull, provimet e ndërmjetme zhvillohen në javën e 7-të të semestrit me kohëzgjatje normale, ndërsa provimet përfundimtare në fund të semestrit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin dhe në procesverbalin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore. Për studentin, që nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, Sekretaria Mësimore bën shënimin “Nuk u paraqit” në procesverbalin përfundimtar të lëndës. Për studentin që humbet të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar të një lënde për shkak të tejkalimit të numrit të mungesave, Sekretaria Mësimore bën shënimin “Nuk u kualifikua”.(E.7, pika 5.3)
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen me vlerësimet e marra në lëndë. Për këtë shërben edhe sistemi LMS. Po ashtu studenti ka të drejtën e kërkesës dhe ankimit në lidhje me vlerësimin e lëndës dhe secilin prej komponentëve të tij. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t’i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Drejtuesi i Departamentit, ngre një Komision ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, për shqyrtimin e
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.	

Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Kjo dokumentohet dhe arkivohet. (E.5, neni 32; E.7, pika 5.8)			
<b>Konkluzione</b>	<i>Testimi dhe vlerësimi në lëndë, realizohet gjatë gjithë vitit akademik (vlerësimi i vazhduar), duke dhënë në fund rezultatin/notën përfundimtare. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë, u bëhen me dije studentëve dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregullore. Për këtë shërben edhe sistemi LMS. Po ashtu studenti ka të drejtën e kërkesës dhe ankimit në lidhje me vlerësimin e lëndës dhe secilin prej komponentëve të tij.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi MSH “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, me dy profile “E Drejtë Penale” dhe “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”, synon që t’i japë studentit dhe ta pajisë atë me njohuri dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik, që të jenë konkurrentë të denjë në tregun e punës. Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program studimi, dhe kreditet për secilën prej tyre mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Ky program studimi synon të ofrojë - në përputhje me filozofinë e UET-it – një kurrikul të thelluar teorike dhe praktike me synimin për dijësuar studentët me aftësi analitike për të kuptuar dhe ofruar zgjidhje potenciale për problemet juridike në kontekstin e të drejtës publike dhe ndërkombëtare. (E.7; E.17)

44

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thëllon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale, analitike e të menduarit kritik në fushë. Gjithashtu ai synon të forcojë komunikimin dhe ndërveprimin mes studentëve si dhe punën në grup. Objektivi final i Masterit është krijimi i specialistëve me formim teorik të thelluar dhe me kapacitete për kërkim shkencor të matshëm, aftësi të përshtatshme për integrimin në tregun e punës në nivel kombëtar, rajonal por edhe më gjerë. Për këtë qëllim, Universiteti Europian i Tiranës vë në dispozicion të studentëve infrastrukturën, metodologjitë dhe informacionet shkencore më të plota dhe më të gjera në fushën e Drejtësisë. (E.14 - E.14.4; E.17).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në syllabuset e çdo lëndë studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë, rezultatet e të nxënit, që marrin në lëndë. Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në lëndë mund të evidentohen përmes vlerësimit të studentit, në gjithë treguesit që ka ky vlerësim. Në përfundim të lëndës, pedagogu bën një përmbledhje të çështjeve kryesore që janë trajtuar gjatë zhvillimit të lëndës si dhe orienton studentët për provimin përfundimtar. (E.7; E.19).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi, kombinon formimin teorik me aspektin praktik. Gjithashtu theksohet bashkëpunimi me institucione të ndryshme pranë të cilave mund të zhvillohen edhe praktika profesionale. Orët e praktikave profesionale janë të detyrueshme për programet e ciklit të dytë në masën 80%. Praktika zhvillohet në një nga institucionet me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi dhe koordinohet e mbikqyret nga një pedagog i departamentit. Në kuadër të mbarëvajtjes së realizimit të programit të studimit që ofron, si dhe në përmbushje të prioritetëve në planet strategjike të zhvillimit të programit të studimit, janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione që ushtrojnë veprimtari në fushën e drejtësisë, akademisë, mbrojtjes juridike, dhe administratës publike. Me një pjesë të këtyre institucioneve, bashkëpunimet</p>

<p>përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>janë formalizuar zyrtarisht përmes akt-memorandumeve, apo marrëveshjeve të nëshkruara për këtë qëllim.</p> <p>Si pjesë e veprimtarive ekstrakurikulare janë edhe orët/leksionet e hapura, me lektorë të ftuar, të cilat janë organizuar herë pas here në UET. Ndër to përmendim trajnime/aktivitete të dedikuara për stafin si p.sh. trajnimi mbi përdorimin e platformës LMS; në kuadër të trajnimit të menaxherëve të UET për mënyrat e reja të mësimdhënies, në Gusht 2021 u zhvillua një trajnim nga Deloitte mbi “Kampusin Hibrid”; në Janar 2022 u zhvillua një trajnim 2 ditor me të gjithë stafin pedagogjik me qëllim rritjen e performancës së pedagogëve nëpërmjet metodave të reja të mësimdhënies, etj.</p> <p>Ky Program, për vetë fushën e studimit në të cilën zhvillohet, ka një qasje të gjerë rreth problemeve të rëndësishme me të cilat përballet sot shoqëria shqiptare, si për sa i përket njohurive më të thelluara dhe problematikave që ndeshen në praktikën gjyqësore në fushën e të drejtës penale, administrative, publike e kushtetuese. Programi kombinon teorinë dhe praktikën duke synuar nxitjen e studentëve për përvetësimin e dijeve bashkëkohore. Programi i studimit mbështetet nga një staf akademik i përgatitur në kontekstin e mësimdhënies dhe didaktikave mësimore që përdor për të nxitur të mësuarin me baza të shëndosha dhe nxitjen e mendimit krijues dhe shkencor te studentët. Realizimi i objektivave të programit përkon me objektivat strategjike të universitetit. Ai mbështetet nga një infrastrukturë cilësore në procesin e mësimdhënies dhe në mjediset e tjera mbështetëse. (E.7; E.17; E.32; E.32.1; E.33).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>UET siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Si pjesë e ristrukturimit të revistave shkencore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të produktit të kërkimit shkencor, UET ofron trajnime për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik. Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET. Kontributi individual i secilit pedagog në kërkimin shkencor zhvillohet sipas drejtimit të kërkimit ku pedagogu</p>

	<p>është i përfshirë. Si pjesë e këtyre aktiviteteve me fokus stafin akademik mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në datën 9 qershor 2022 u zhvillua trajnimi “Publish or Perish”, në kuadër të mënyrave të kërkimit shkencor dhe publikimit të tyre. Ky trajnim është pjesë e aktiviteteve për zhvillimin e stafit që UET organizon çdo vit akademik;</li> <li>- Në datën 16.06.2022, u zhvillua trajnimi për projektet kërkimore "Hints and Tips on research projects funding".;</li> <li>- Në datën 19.10.2022 u zhvillua Trajnimi "Metodat Inovative të mësimdhënies-Studenti në qendër";</li> <li>- Në kuadër të projektit QUADIC dhe të Qendrave Kërkimore UET, në datat 5-6-7 Dhjetor 2022 u organizuan disa trajnime nga Universitë për Stranieri di Perugia, një nga partnerët kryesorë europiane të projektit QUADIC;</li> <li>- Në datën 15.12.2022 në kuadër të projektit “INTERBA”, u zhvillua trajnimi me temë “Research Methodologies in Communication and Media”;</li> <li>- Në datën 31.01.2023, u zhvillua Ëorkshop/Trajnimi “Tutoring: The Relaunch” që pati në qendër shërbimin e tutoriatit në mbështetje të studentëve të ciklit të parë të studimeve;</li> <li>- Ndërsa në datën 06.02.2023, u zhvillua seanca e dytë e Workshopit/Trajnimit “Tutoring: The Relaunch.” (E.17; E.32; E.33).</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Sipas “Strategjisë Kërkimore Shkencore” dhe Planit Strategjik UET 2021-2025, kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore.</p> <p><i>Megjithatë, gjatë vizitës në institucion, nuk morëm ndonjë shembull të një mbështetje të tillë financiare për raste të studentëve të këtij programi studimi MSH.</i></p> <p><b>(E.3.1; E.3.2; E.3.3).</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi MSH “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, me dy profile “E Drejtë Penale” dhe “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”, synon që t’i japë studentit dhe ta pajisë atë me njohuri dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij</i></p>

	<p><i>praktik, që të jenë konkurrentë të denjë në tregun e punës. Programi i studimit mbështetet nga një staf akademik i përgatitur në kontekstin e mësimdhënies dhe didaktikave mësimore që nxit mendimin krijues dhe shkencor të studentët. Ai mbështetet nga një infrastrukturë cilësore në procesin e mësimdhënies dhe në mjediset e tjera mbështetëse. Në dokumentacionin UET, thuhet se institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato, por gjatë vizitës në institucion, nuk morëm ndonjë shembull të një mbështetje të tillë financiare për raste të studentëve të këtij programi studimi MSH.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Ky program studimi mbyllet me mbrojtjen e diplomës para komisionit të posaçëm që ngrihet për këtë qëllim. Diplomimi i studentit kryhet vetëm pasi ai ka shlyer/realizuar të gjitha detyrimet e tjera të këtij program studimi. Mbrojtja e diplomës është publike. Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome, i cili është produkt krijues dhe me origjinalitet i studentit; mund të ketë karakter teorik ose empirik. Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë (B.II).</p> <p>Departamenti dhe Grupi kërkimor në përcaktimin përfundimtar të udhëheqjeve duhet të harmonizojë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Ekspertizën e udhëheqësit;</li> <li>Ngarkesën e çdo pedagogu;</li> <li>Shpërndarjen e harmonizuar të studentëve, duke mbajtur parasysh edhe nivelin e tyre në bazë të rezultateve të arritura gjatë studimeve;</li> </ol>



	<p>Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur. Kalendari akademik parashikon 4 (katër) sezone për mbrojtjen e diplomës, të cilat janë: (1) Java e 1- rë e tetorit (2) Java e 2- të e nëntorit (3) Java e 1- rë e marsit (4) Java e 3-të e korrikut. Studenti që merr notë jokalue në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studenti duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome. <b>(E.7, pika 8; E.10).</b></p>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</b></p>	<p>Në rastin e studentëve të programit të studimit MSH “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”, me profile “E Drejtë Penale” dhe “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese”, detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të UET-së. Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i UET-së, të profilizuar në fusha të caktuara. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët mbi bazën e kërkesave që ata paraqesin dhe temave të propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Çdo anëtar i personelit akademik, brenda muajit tetor, njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema diplomash. Brenda javës së pestë të semestrit të parë të vitit akademik, studentët pajisen nga Departamenti me formularin e aplikimit për temën e diplomës formati B.II.2.1.2 (MSH), shoqëruar me listën e pedagogëve të mundshëm udhëheqës dhe me inventarin e temave të propozuara. UET ka miratuar dhe ka në dispozicion një dokument të posaçëm që B.II – “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit” i cili u vihet në dispozicion studentëve për t’u njohur me kriteret, procedurat, afatet për mbrojtjen e diplomës. <b>(E.7; E.10)</b></p>
<p><b>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha</b></p>	<p>N / A</p>

lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi pasi miratohet nga departamenti, zhvillon seanca metodologjike me grupin e studentëve që ai udhëheq, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë studentët të përpunojnë aspektin metodologjik të punës së tyre për hartimin dhe paraqitjen e punimit të diplomës. Udhëheqësit e temave të diplomës mentorojnë studentin gjatë periudhës për përgatitjen e saj. Udhëheqësi orienton studentin në lidhje me përgatitjen e temës, në përmbushje të standardeve të miratuara për këtë qëllim në Dokumentin B.II lidhur me procedurën për përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës që i vihet në dispozicion studentëve. Punimi i diplomës duhet të respektojë kërkesat e formatit, teknike dhe rregullat e etikës akademike që zbatohen në UET (Kodi i Etikës), duke evituar plagjaturën. Në përfundim të saj dhe para mbrojtjes, udhëheqësi duhet të japë dakordësinë e tij dhe e firmos temën e diplomës që studenti do mbrojë para komisionit. (E.10; E.16)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>UET i ndihmon studentët për të realizuar studimet e tyre, duke u krijuar lehtësira të ndryshme. Për përgatitjen e temës së diplomës, ambiente të tilla si p.sh biblioteka me sallën e kompjuterave, mund të përdoren si nga studentët ashtu edhe nga stafi i UET-së për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, apo për hedhjen e të dhënave grafike dhe statistikore që mund t'i duhet një studentit për të përgatitur temën e tij të diplomës. Po ashtu, në kuadër të bashkëpunimeve që ka UET me institucione dhe subjekte të tjerë, mund të fasilitohen studentët në lidhje me hulumtime apo punë në terrën dhe arkiva, marrje informacioni të nevojshëm në funksion të temës, realizim pyetsorësh apo anketimi për efekt hulumtimi etj. (E.7; E.17; E.34).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Mbrojtja e diplomës bëhet para komisionit të posaçëm të ngritur për këtë qëllim dhe vlerësohet me notë. Rezultati shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Formatet përkatëse të vlerësimit të Komisionit të Mbrojtjes, bëhen pjesë e dosjes pas mbrojtjes së punimit. Koordinatorja e</p>

	<p>Departamentit garanton që këto të jenë plotësuar në mënyrë korrekte dhe firmosur në origjinal. Rezultati përfundimtar shënohet në Proces-verbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.</p> <p><b>(E.7; E.10).</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të pajiset me Diplomën përkatëse, kur përfundon me sukses këtë program studimi. Studenti pajiset me diplomë jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e mbrojtjes dhe njoftohet për mundësinë e tërheqjes së saj. Përpara pajisjes së studentit me diplomën përkatëse, Sekretaria Mësimore verifikon rezultatet e provimeve, të praktikës profesionale dhe të punimit të diplomës dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara për përfundimin e programit të studimit. Zyra e Regjistrimit të Studentëve (Registry) dhe Zyra e Financës verifikojnë statusin e detyrimeve financiare të diplomantit. Sekretaria Mësimore harton dhe e pajis studentin me <i>Suplementin e Diplomës</i>, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). Çdo diplomë, përpara se të lëshohet nga UET, regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><b>(E.10, pika B.II.15; E.15.1; E.15.2; E.15.3; E.15.4).</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UET ruan kopjet e dorëzuara të diplomave që studentët mbrojnë para komisionit të diplomimit. Arkivimi dhe ruajtja e Punimeve të diplomës/disertacioneve kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procedurës së mbrojtjes. Punimet e diplomës së ciklit të dytë, me vlerësim 7 e lart, në versionin e printuar ruhen në Bibliotekën e Universitetit dhe të Departamentit përkatës. Versioni elektronik i tyre, së bashku me versionin e printuar dhe elektronik të punimeve të tjera, dorëzohen nga Koordinatorja e Departamentit përkatës në Zyrën e Protokollit dhe Arkivit. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, paraqitet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. UET disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe i përpunon ato për efekt raportesh apo të dhënash statistikore. <b>(E.10, pika B.II.16; E.12).</b></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>UET ka një procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. Sipas temës dhe fushës së studimit, si dhe brenda mundësive, UET i ndihmon studentët për të realizuar studimet e tyre, duke u krijuar lehtësira të ndryshme. Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome, i cili është produkt krijues dhe me origjinalitet i studentit, me karakter teorik ose empirik. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, sipas formatit të miratuar për këtë qëllim.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë për mësimdhënie dhe realizimin e punëve praktike. Disa prej auditorëve janë të pajisura edhe me logjistikën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe akademik, duke plotësuar kërkesat për zhvillimin normal të veprimtarive të këtij program studimi.  Sallat e leksioneve janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si: videoprojektor, PC, foni etj. Kjo jep mundësi, që mënyra e realizimit të mësimdhënies të bëhet me metoda e teknologji bashkëkohore. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirish internetin. Kjo u evidentua edhe gjatë vizitës së GVJ-së në institucion. (E.42; E.42.1; Minutat e vizitës në UET).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe	Studentëve u mundësohet kryerja e praktikave në institucione të ndryshme me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga kontaktet e vazhdueshme me institucione, biznese dhe studio ligjore janë arritur të nënshkruhen marrëveshje si dhe të pasurohen me marrëveshje të reja bashkëpunimi. Këto praktika

<p>teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimim më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>synojnë përfitimim e njohurive dhe kompetencave profesionale në fushë. Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit luan rol me rëndësi në mbështetjen që u jep studentëve gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke ofruar konsulencë për aplikime dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit, stazhe, internshipe etj. apo mundësitë për vazhdimin e specializimeve brenda ose jashtë vendit me qëllim përfitimim sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. Zyra e Këshillimit të Karrierës realizon parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/stazheve/internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë. (E.12; E.32; E.32.1; E.34).</p>
<p><b>Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</b></p>	<p>Praktika profesionale për programet Master i Shkencave ka 12 kredite; pra një detyrim prej 300 orë punë për studentin. Nga këto 8 orë në auditor (4 seanca nga 2 orë seanca), 240 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 52 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj). Seancat në auditor zhvillohen nga pedagogë të trajnuar dhe nga ekspertë të ftuar, të cilët si rregull, janë anëtarë të Bordit të Tregut të Punës të departamentit përkatës. Qëllimi i seancave në auditor është t'u japin studentëve njohuritë bazë mbi menaxhimin e karrierës dhe t'i informojnë për tregun e punës dhe qasjen ndaj tij. Gjithashtu, studenti merr informacionin e plotë mbi praktikën profesionale dhe për dokumentacionin e nevojshëm. Në programet e ciklit të dytë të studimeve, studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion/organizatë/kompani. Studenti dorëzon dosjen e praktikës shoqëruar me vlerësimin nga pedagogu përgjegjës. Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, pedagogu që e mbikqyr studentin gjatë praktikës ka për detyrë të dorëzojë pranë Koordinatorës së Departamentit formularin e vlerësimit të studentit, formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në institucion/organizatë/kompani, formularin e vetëvlerësimit të plotësuar nga studenti dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës. Vlerësimi i studentëve për praktikën profesionale bëhet nga një komision vlerësues, i cili propozohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani.</p>

	Komisioni përbëhet nga pedagogu që e ka mbikëqyrur studentin gjatë praktikës, pedagogu përgjegjës për procesin e praktikave, një ose dy pedagogë të tjerë nga Departamenti, si dhe mund të ftohen anëtarë të Bordit të Tregut të Punës.  (E.7; E.12; E.32; E.32.1; E.32.2).			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë për mësimdhënie dhe realizimin e punëve praktike. Disa prej auditorëve janë të pajisura edhe me logjistikën e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe akademik, duke plotësuar kërkesat për zhvillimin normal të veprimtarive të këtij program studimi.</i></p> <p><i>Studentëve u mundësohet kryerja e praktikave në institucione të ndryshme me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe janë arritur të nënshkruhen marrëveshje të reja bashkëpunimi. Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit luan rol me rëndësi në mbështetjen që u jep studentëve gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke ofruar konsulencë për aplikime dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit, stazhe, internshipe etj. me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p><b>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</b></p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike, ku përfshihet edhe programi i vlerësuar, ka të angazhuar personel akademik me përvojën e duhur në fushën e të drejtës publike, kushtetuese, penale dhe nderkombëtare. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, referuar listës së stafit akademik të angazhuar në këtë program, janë angazhuar staf akademik për tre vite akademike si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik 2019- 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 2 PAK (82 % /18 %);</li> <li>2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 14 PAE dhe 6 PAK (70 % / 30 %);</li> <li>3. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 3 PAK (78 % / 22 %);</li> </ol> <table border="1" data-bbox="603 1055 1383 1462"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2019 – 2020</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>8</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>9</td> <td>2</td> <td>14</td> <td>6</td> <td>10</td> <td>3</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare me profile, janë angazhuar edhe staf akademik me Msc, (15 % - 27 %) ndër vite, në ndryshim nga parashikim i nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: <i>“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që Departamenti të mundësojë që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në</i></p>	Tituj/grada	2019 – 2020		2020 - 2021		2021 - 2022		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	2	-	1	-	1	-	Prof.As.Dr	1	-	1	-	1	1	Dr/PhD	4	1	8	5	6	2	Msc	2	1	4	1	2	-	Në total	9	2	14	6	10	3
Tituj/grada	2019 – 2020		2020 - 2021		2021 - 2022																																												
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																																											
Prof.Dr	2	-	1	-	1	-																																											
Prof.As.Dr	1	-	1	-	1	1																																											
Dr/PhD	4	1	8	5	6	2																																											
Msc	2	1	4	1	2	-																																											
Në total	9	2	14	6	10	3																																											

	<p>mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p> <p><b>(E.20; E.22.a, 22.b; E.7.a, 7.b, 7.c; E.44.1; E.44.2; Aneks RVB -Tabelat përmbledhëse).</b></p>																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dosje, personeli akademik i brendshëm i Departamentit të Shkencave Juridike, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>19-20</td> <td>1448</td> <td>1148</td> <td>300</td> <td>80% / 20 %</td> </tr> <tr> <td>20-21</td> <td>1260</td> <td>1020</td> <td>240</td> <td>80% / 20 %</td> </tr> <tr> <td>21-22</td> <td>1328</td> <td>1148</td> <td>180</td> <td>86% / 14%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga sa më sipër rezulton se ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.</p> <p><b>(E.8.a; E.11; Aneks RVB -Tabelat përmbledhëse).</b></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	19-20	1448	1148	300	80% / 20 %	20-21	1260	1020	240	80% / 20 %	21-22	1328	1148	180	86% / 14%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
19-20	1448	1148	300	80% / 20 %																	
20-21	1260	1020	240	80% / 20 %																	
21-22	1328	1148	180	86% / 14%																	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dosje, jo vetëm të dhënat financiare, e dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri, por edhe elementë të tjerë të menaxhimit të personelit, procedura transparente rekrutimi, vlerësimi i performances i orientuar drejt zhvillimit profesional dhe personal, incentiva të ndryshme motivimi, etj.</p> <p><b>(E.7.a, 7.b, 7.c; E.11; E.28.5; E.41; E.43; Minutat e vizitës në UET)</b></p>																				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në</p>	<p>Sipas DVV dhe verifikimit gjatë vizitës në institucion, vërehet se, të gjithë elementët e menaxhimit të personelit, duke përfshirë edhe rekrutimin dhe vlerësimin e performances, realizohen jo</p>																				



<p>kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>vetëm formalisht, por edhe në respektim të standardeve, duke garantuar për zgjedhjen dhe mirëmbajtjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><b>(E.7.a, 7.b, 7.c; E.11; E.11.1; E.41; E.43; Minutat e vizitës në UET)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në lidhje me personelin ndihmës akademik në Departamentin e Shkencave Juridike, sipas të dhënave institucionale, deklarohet se, në UET në strukturën e tij nuk ka personel që kryen vetëm rol ndihmës akademik me karakter mësimor/administrativ. Njësitë administrative të ngritura në nivel institucioni, janë në mbështetje të drejtuesve dhe anëtarëve të personelit akademik, për të arritur objektivat e secilit program. <b>(E.7; Minutat e vizitës në UET)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dojes, deklarimeve të drejtuesit të Departamentit të Shkencave Juridike, deklarimit të përfaqësuesit të Burimeve Njerëzore, të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme, në të cilat depozitohet i gjithë dokumentacioni.</p> <p><b>(E.11; E.44.1; E.44.2; Aneks RVB -Tabelat përmbledhëse)</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues</p>	<p>Sipas DVV dhe deklarimeve të drejtuesit të Departamentit të Shkencave Juridike, vërehet se, me ndihmën edhe të Zyrës së Karrierës, ka lidhur memorandume bashkëpunimi me institucione publike, studio ligjore, duke mbajtur komunikim të</p>

<p>biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione dhe për të ftuar ekspertë të fushës në auditore. Po ashtu, vërehet se, prej këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi janë krijuar lidhje konkrete ndërmjet universitetit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit.</p> <p><b>(E.5.a, 5.b; E.32.1; E.32.2; E.34; E.35; E.54.10; B-I-3).</b></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Referuar dokumentacionit në dosje, UET garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve.</p> <p><b>(E.5.a, 5.b; E.12.5; E.19; E.32.1; E.32.2; E.34; E.35; E.54.10; B-I-3).</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i Shkencave Juridike, ku përfshihet edhe programi i studimit MSH "E drejtë publike dhe ndërkombëtare", ka të angazhuar personel akademik me përvojën e duhur në fushën e të drejtës publike, kushtetuese, penale. Përmbushen kriteret ligjore formale, si ai i gradës shkencore, titullit akademik dhe eksperiencës në punë, dhe ekspertizës përkatëse në fushë. Personeli akademik me kohë të plotë i Departamentit të Shkencave Juridike, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit. Rekomandohet gjithashtu marja e masave të nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë të angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr. në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UET ushtron akritetin e tij prej vitit akademik 2021-2022, e në vazhdim, në kampusin e ri universitar me adresë Rruga "Xhanfize Keko", Nd. 56, në Tiranë. Mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 7,545 m <sup>2</sup> . Në këtë shifër nuk përfshihet sipërfaqja përreth godinave. Sipërfaqet e shfrytëzueshme janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 15 salla me sipërfaqe totale 1447 m <sup>2</sup> dhe 1138 vende. Salla seminari janë gjithsej 13, me sipërfaqe 561 m <sup>2</sup> , dhe 353 vende.  (E.42; E.42.1; Minutat e vizitës në UET).
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion del se UET ka në përdorim 7 laboratorë mësimore informatike, 1 sallë interneti 70 vende, dhe auditore të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Labororet e informatikës/statistikës janë pajisur me softëare përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire programit mësimor. Po ashtu, UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, material shtesë audio vizive etj.  (E.42; E.42.1; E.46.1-46.4; Minutat e vizitës në UET).
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset	Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion, në UET mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio

<p>e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Gjithashtu janë edhe disa Laboratorë të tjerë mësimorë, ku numri i tyre është 9. <b>(Minutat e vizitës në UET).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion rezulton se UET ka në përdorim 7 laboratorë mësimorë informatike të cilët janë në dispozicion për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë dhe mjaftueshëm salla mësimore për zhvillimin e procesit akademik (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. <b>(Minutat e vizitës në UET).</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë</p>	<p>UET garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion sikurse dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme (12), ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. <b>(Minutat e vizitës në UET).</b></p>
<p>strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	

<b>Konkluzione</b>	<i>UET siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Po ashtu, UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin UET LMS, i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, material shtesë audio vizive etj. UET garanton mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Sipas dokumentacionit institucional, vërehet se, në syllabusin e secilës lënde, vendoset literature bazë dhe ndihmëse, të cilat i lejojnë studentëve marrjen e njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Literatura u vendoset studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës. Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, përdoren libra të botuara nga shtëpitë më të mëdha botuese kryesisht të huaja dhe të botuara brenda 5 viteve te fundit. Në mungesë të teksteve të azhurnuara të fushës së Drejtësisë në gjuhën shqipe, disa nga literaturat bazë ofrohen në gjuhën angleze, ndërkohë që leksionet përgatiten në gjuhën shqipe nga pedagogu i lëndës. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5- vjeçare në libraritë elektronike Sage &amp; Ebsco si edhe Questia. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).</p> <p><b>(E.19; E.22.a, 22.b; E.1/dok.shtesë; Minutat e vizitës në UET).</b></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me literaturën, kryesisht përdoren libra të botuara nga shtëpitë më të mëdha botuese kryesisht të huaja dhe të botuara brenda 5 viteve të fundit dhe në gjuhën angleze.</p> <p><b>(E.19; Minutat e vizitës në UET).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UET ka një bibliotekë, e cila është e vendosur në godinën C dhe me një sipërfaqe prej 35 m<sup>2</sup>, është e aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë, përfshirë dhe studentët e këtij programi studimi.</p> <p><b>(Minutat e vizitës në UET).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni në dosje si edhe verifikimeve në terren gjatë vizitës në institucion, Biblioteka ka një fond të konsiderueshëm të përbërë nga libra, periodik, CD dhe harta), në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Aksesit literaturës së programit nga studentët, garantohet nëpërmjet: Literaturës fizike në bibliotekë, Aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questial, Katalogut të librave elektronik e krijuar nga biblioteka, i cili ka në gjuhë të huaj qindra tituj, Materialeve të vëna në dispozicion nga titullarët në sistemin UET LMS.</p> <p><b>(E.1/dok.shtesë; E.45; E.45.1; E.45.3; Minutat e vizitës në UET)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas DVV, abonimi në bibliotekat elektronike Sage, Ebsco dhe Questia dhe kapacitete infrastrukturore në bibliotekë (PC, wi-fi) janë për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët.</p> <p><b>(Minutat e vizitës në UET)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka ofron akses në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë në bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga institucioni. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën</p>

	bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse. <b>(Minutat e vizitës në UET).</b>
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga dokumentacioni në dosje si edhe verifikimeve në terren gjatë vizitës në institucion, orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hënë-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur. <b>(E.45.1).</b>
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Sipas deklaratimit të përfaqësuesit të Bibliotekës, si edhe verifikimeve në terren, pasurimi i fondit të bibliotekës është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve LMS. <b>(E.1/dok.shtesë; E.45; E.45.1; E.45.3; Minutat e vizitës në UET)</b>
<b>Konkluzione</b>	<i>Në syllabusin e secilës lënde, vendoset literatura bazë dhe ndihmëse, të cilat i lejojnë studentëve marrjen e njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Literatura u vendoset studentëve në dispozicion, në mënyrë fizike ose elektronike (në sistemin LMS) nga pedagogu i lëndës. Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, perdoren libra të botuara nga</i>

	<p>shtëpitë më të mëdha botuese kryesisht të huaja dhe të botuara brenda 5 viteve të fundit. Disa nga literaturat bazë ofrohen në gjuhën angleze, ndërkohë që leksionet përgatiten në gjuhën shqipe nga pedagogu i lëndës. Biblioteka e institucionit është e aksesueshme nga të gjithë studentët në mënyrë të barabartë, përfshirë dhe studentët e këtij programi studimi. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5- vjeçare në libraritë elektronike Sage &amp; Ebsco si edhe Questia. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET ka një sistem nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, - nga regjistrimi deri në diplomim, - i cili quhet UMIS. Ky system është një program informatik, që bën ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Vërehet se, një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, sëbashku me rezultatet e provimeve ndër vite. (E. 46).
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe	Sipas deklarimit të drejtuesve, si edhe verifikimeve në terren, UET nuk ka një sistem nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me personelin, HRMS: pagesa, vlerësimi performances, etj. Por është në proces të ndërtimit të një sistemi të tillë. Ndërsa, aktiviteti i tyre akademik – mësimdhënës, administrohet prej sistemit LMS. (E.46.2).



partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sipas sqarimeve të dhëna dhe verifikimit në terren, UET, si e kemi cituar, ka vënë në përdorim platformen UET LMS, për personelin dhe studentet e programit të studimit, duke filluar nga viti akademik 2016-2017. Aktualisht, sistemi UET LMS ka si zëra: regjistrimi i studentëve në lëndët e tyre përkatëse dhe kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin. Ndërsa, personeli akademi është regjistruar në sistem në lëndët e veta dhe mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që personeli akademik mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. (E.46.2; E.46.3).
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	LMS është një system që lehtëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet, detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme. Ndërsa për personelin akademik ofron mundësi për çdo lloj kërkese që mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies. (E.46.2; E.46.3).
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sipas sqarimeve të dhëna, sistemet janë mjete efikente për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik, përmes gjenerimit në kohë reale të të dhënave statistikore.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në	Sipas verifikimit faqja zyrtare e UET është: <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a> . Faqja zyrtare përmban informacion të plotë, në dy gjuhë shqip dhe anglisht, mbi filozofinë dhe misionin, partneret, drejtimin dhe funksionimin, organigramën; guidat për studentët e

faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. ( <a href="https://uet.edu.al/">https://uet.edu.al/</a> <a href="https://uet.edu.al/en/">https://uet.edu.al/en/</a> ).			
<b>Konkluzione</b>	<i>UET disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. UET ka një sistem nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim, i cili quhet UMIS. Ndërsa, aktiviteti i tyre akademik – mësimdhënës, administrohet prej sistemit LMS.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UET është IAL jo publike që zhvillon aktivitetin e tij kryesisht mbi bazën vetëfinancimit dhe/ose financime të tjera. Burimet e financimit dhe menaxhimi i fondeve përcaktohen dhe aprovohen nga Bordi i Administrimit. Po ashtu, veprimtaria kërkimore e shkencore financohet nga vetë universiteti apo edhe nga projekte të ndryshme ku merr pjesë apo edhe donacione të ndryshme legjitime. UET harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura, e duke analizuar shpenzimet operationale dhe ato kapitale. Në të përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, etj. Analiza e kostos së programeve shqyrtohet në raport me të ardhurat që burojnë nga këto programe. Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga

	<p>universiteti, për tre vitet e fundit, të ardhurat janë gjerneruar nga: tarifat për dhe gjatë shkollimit, grantet për kërkim dhe kontratat si dhe aktivitete tregtare. (E.2; E.3.1/dok.shtesë; E.5; E.50.5; E.50.6; E.50.7; E.13.2/dok.shtesë; E.13.3/dok.shtesë; Minutat e vizitës në UET).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe sqarimeve të dhëna, vërehet se, UET ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete financiare për të përballuar këtë program studimi, por mbetet të analizohet ecuria e këtij programi studimi dhe kostoja për mbajtjen e tij në të ardhmen, për më tepër nisur nga numri i vogël i studentëve për dy vite akademik dhe kalimit në programin e integruar 5 vjeçar të studimit në drejtësi.</p> <p><i>Kështu që GJVJ rekomandon që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi MSH, për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit dhe nëse do të vijojë mbështetjen financiare nga Universiteti, nisur nga numri i vogël i studentëve dhe aplikimit të sistemit të integruar 5 vjeçar në drejtësi.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Referuar dokumentacionit institucional, UET kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. Ndaj, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. (E.50.5; E.50.6; E.50.7; E.13.1; E.13.2).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e</p>	<p>Referuar RVB, në bazë të buxhetimit financiar të miratuar çdo vit, përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe</p>

<p>njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>shpenzimeve, duke saktësuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Burim kryesor financimi për programin janë tarifatat e ndryshme të shkollimit, kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj ku UET është pjesëmarrës etj.</p> <p>Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi. Për të kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve, mban të dhëna krahasuese edhe për vitet e kaluara duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesore që ndikojnë në performancën e qëndrueshme dhe rezultateve të institucionit. (E.50.5; E.50.6; E.50.7)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njesisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nga informacioni dhe vizita institucionale, rezultojnë se Institucioni ka stabilitet financiar dhe kapacitet financiar për të garantuar në vijim aktivitetin akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet duke mbajtur parasysh kërkesat e shprehura prej njësive/strukturave të universitetit, me qëllim arritjen e objektivave, si dhe realizimin e misionit të tij. Në buxhetin vjetor të Universitetit, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve, të ardhurat dhe shpenzimet e kryera. Të ardhurat e krijuara nga Universiteti përdoren prej tij në funksion të veprimtarisë akademike, administrative e kërkimore-shkencore.</p> <p><i>Njëjtë si tek kriteri 1 më sipër, GJVJ rekomandon që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi MSH, për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit dhe nëse do të vijojë mbështetjen financiare nga Universiteti, nisur nga numri i vogël i studentëve dhe aplikimit të sistemit të integruar 5 vjeçar në drejtësi.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare të tij në përputhje me aktet e brendshme dhe rregullimet ligjore. Ai zbaton gjithashtu edhe detyrimet që lidhen me vlerësimin e situatës financiare nëpërmjet auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm të veprimtarisë financiare.</i></p> <p><i>UET harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me</i></p>


	<p><i>kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura, e duke analizuar shpenzimet operationale dhe ato kapitale.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi MSH, për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit dhe nëse do të vijojë mbështetjen financiare nga Universiteti, nisur nga numri i vogël i studentëve dhe aplikimit të sistemit të integruar 5 vjeçar në drejtësi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Ky program studimi ofrohet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi si dhe aktet rregullatore të nxjerra nga UET që lidhen me politikat studentore nga hyrja në dalje. Nëpërmjet politikave, kriterëve dhe procedurave, synohet të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatët me rezultate sa më të larta. Kuotat, kriteret e pranimit dhe procedura e pranimit bëhen publike për çdo vit akademik si dhe publikohen online. Në UET mund të ndjekin programe të ciklit të dytë edhe personat që vijnë me transferim, duke kërkuar njohje të krediteve të mëparshme të tyre apo edhe ata që duan të ndjekin një program të dytë studimi. Institucioni ka miratuar rregulla mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve për të gjitha ciklet e studimit. Informacioni përkatës gjendet edhe në


	<p>Guidën/manualin UET, bëhet i njohur përmes fushatave informuese si dhe gjatë këshillimit në institucion. Gjithashtu, UET ka të dhëna për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve në këtë program studimi. (E.5; E.7; E.27; E.27.1).</p>
<p><b>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</b></p>	<p>Ky program studimi është hartuar dhe zbatohet duke marrë parasysh lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fuqi. Si i tillë, ai garanton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë në UET si dhe për studentët e këtij program studimi. Të drejtat dhe detyrat e studentëve parashikohen në Statutin dhe Rregulloren e universitetit, si dhe në Rregulloren e këtij programi studimi dhe po ashtu në Broshurën e Dokumenteve.</p> <p>Procedurat dhe politikat e ndjekura nga hyrja në dalje nga UET garantojnë barazinë si për kandidatët e interesuar për të ndjekur një program studimi ashtu edhe për studentët që ndjekin programin e studimit. Kuotat dhe kriteret e pranimit miratohen sipas procedurave ligjore dhe ato janë të shpallura publikisht e janë të aksesueshme nga të gjithë. Informacioni publikohet edhe në faqen zyrtare të UET-së.</p> <p>Njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përfuara në një IAL tjetër është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore. Është e mundur njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose jashtë universitetit. Pranë Departamentit ngrihet Komisioni Ad-hoc i cili vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm, sipas përcaktimeve në rregulloren e Universitetit dhe bën njohjen e krediteve përkatëse për disipinat mësimore të likuiduara. Modalitetet dhe procedurat për transferimin e studentëve janë të përcaktuara në një dokument të posaçëm. Komisioni i Njohjes (KNJ) ngrihet në nivel departamenti për të shqyrtuar kërkesat e studentëve për transferim studimesh dhe/ose njohje kreditesh. KNJ-ja, si rregull, kryesohet nga Drejtuesi i departamentit dhe ka në përbërje përgjegjësit e grupeve mësimore. Në raste të veçanta Drejtuesi i Departamentit ka të drejtë të caktojë në KNJ edhe pedagogë të tjerë të fushës. KNJ duhet të marrë vendim përfundimtar brenda ditës kur merr në dorëzim dosjen e studentit prej Zyrës së Regjistrimit të Studentit.</p> <p>(E.2; E.3.2/dok.shtesë; E.5; E.7; E.28).</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit, struktura e vitit akademik etj. përcaktohen në Rregulloren e institucionit dhe të këtij programi studimi. Pranimi në këtë program studimi MSH bëhet në raport me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të universitetit dhe kuotave që propozon departamenti dhe miratohen në Senat. Këto procedura dhe kritere bëhen publiku edhe online duke lehtësuar aksesin në informacion dhe duke e bërë atë publik para fillimit të vitit akademik. Si program studimi i ciklit të dytë, kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë kritere të përgjithshme (jo të posaçme):</p> <p>Në këto programe pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj, të cilët: a. kanë përfunduar studimet në një i) program studimi të ciklit të parë, në rastin e pranimit në programet e ciklit të dytë, ose ii) në një program studimi të ciklit të dytë (Master i Shkencave/Master i Arteve ose program i integruar i ciklit të dytë) në rastin e pranimit në një program studimi të ciklit të tretë; b. dëshmojnë njohjen e një prej 5 gjuhëve të Bashkimit Europian (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht) përmes testeve të njohura ndërkombëtare, konform përcaktimeve me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin (me përjashtim të programeve Master Profesional). (E.5; E.7; E. 27.1).</p> <p>GVJ konstaton se, pavarësisht se parashikohet ndjkeja e këtij programi studimi nga shtetas të huaj, nuk ka asnjë rregullim se si do të ndiqet ky program studimi nga shtetasit e huaj. Për më tepër programi ofrohet në gjuhën shqipe. <i>GVJ sugjeron që të rishikohet kjo pjesë, ose të shtohen rregullat në lidhje me këtë kategori të mundshme studentësh të huaj që mund të ndjekin këtë program studimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të</p>	<p>Përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimi bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kritereve të vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Po ashtu, rregulla janë vendosur për ndjekjen e kursit, transferimin e studimeve, vlerësimit të njohurive/dijeve dhe të diplomimit. Këto përcaktohen në Statut, Rregulloren e UET-së dhe Rregulloren e programit të studimit MSH "E drejtë publike dhe ndërkombëtare".</p> <p>Kriteret e pranimit për kandidatatët e interesuar shpallen</p>




<p>kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>publikisht bashkë me dokumentacionin që duhet të paraqesë kandidati. Lista e kandidatëve fitues për programet master me renditjen përkatëse bëhet përpara fillimit të procesit mësimor. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH dhe aktet e brendshme rregullatore të UET-së, dhe në përputhje me kuotat e miratuara nga Senati Akademik për atë vit akademik. Kriteret dhe procedurat janë të kuptueshme dhe të aksesueshme edhe online nga të interesuarit, duke garantuar transparencë dhe janë të kuptueshme. (E.2; E.5; E.7; E. 27.1; E.28).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë këtë program studimi MSH “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”. Informimi dhe ndërgjegjësimi i studentëve dhe individëve të tjerë të interesuar për të ndjekur programet Master realizohet nëpërmjet këtyre formave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizim, në mjediset e UET-it, i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuere me grupe studentësh që shfaqin prirje për vijimin e studimeve në ciklin e dytë;</li> <li>- Takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve;</li> <li>- Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuere si: fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promocionale etj;</li> <li>- Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET-it të “Javëve të regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve për ciklin e dytë, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës;</li> </ul> <p>Në përshtatje me teknologjinë, UET prej 5 vitesh është fokusuar në platformat e mediave sociale dhe ato të digjital marketingut në komunikimin e tij, jo vetëm të përditshëm por edhe në raste të fushatave të marketingut. UET nëpërmjet faqes zyrtare të tij, azhuron informacione të detajuara dhe të dhëna</p>






	që i vijnë në ndihmë studentëve aktual dhe atyre potencial për studimet Master. (E.3.2/dok.shtesë, pika D.I.2; E.48; E.51).
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në lidhje me kriteret e pranimit, kriteret janë të përgjithshme të përcaktuara në dok. rregullatore. Në to, nuk ka rregulla specifike për kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Por në dok. e politikave të dhënies së bursave, parashikohen bursat dhe llojet e tyre. Kështu, bursat e plota ose të pjesshme të studimit ofrohen mbi bazën e disa kriterëve përzgjedhjeje me synimin për të nxitur rezultate sa më të larta në studime, si dhe për të luajtur një rol të rëndësishëm social dhe për t'u ardhur në ndihmë shtresave të diskriminuara dhe në nevojë. Kategoritë e bursave që ofrohen nga UET janë: bursë e plotë dhe gjysëm bursë. (E.3.2/dok.shtesë, pika D.V; E.7, pika 2; E.27.1).
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në pranimet në këtë program studimi, përcaktohet se pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kriteret e vendosura në aktet rregullatore të UET. Këto kriteret janë të përgjithshme, të njëjta për shtetasit shqiptarë dhe të huaj. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të çdo Fakulteti për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe rregulloren e UET-it. Gjithashtu, edhe Departamenti mund të propozojë vendosjen e kriterëve shtesë të pranimit, të cilat miratohen në Senat Akademik dhe i njoftohen brenda afateve të përcaktuara ministrisë përgjegjëse për arsimin. Por nga dokumentacioni i konsultura, nuk rezulton që departamenti ka miratuar kriteret të tilla specifike për këtë program studimi MSH. (E.3.2/dok.shtesë, pika D.I.2; E.7, pika 2; E.27.1).
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UET ka politikën e tij të bursave që aplikon sipas specifikave, të përmendura më sipër te Kriteri 6. Llojet e bursave që ofrohen janë: - Bursë Ekselence: Individë me rezultate të shkëlqyera në arsimimin e tyre (Bursë e Plotë për kandidatët me notë mesatare 9.51-10.00 të ciklit paraardhës të studimeve, ose të vitit paraardhës të studimeve në UET, dhe Gjysëm Bursë për kandidatët me notë mesatare 9.00- 9.50). Bursa përfitohet nga studenti për vitet akademike në vijin vetëm në rast të ruajtjes së

notës mesatare të studimeve në UET brenda segmentit të përcaktuar për përfitimin e saj.

- Bursë Kadare: Jepet për programe studimi në fusha të shkencave humane, e në raste të caktuara edhe të edukimit apo shkencave sociale. Lista e programeve për të cilat ofrohet kjo lloj burse, miratohet çdo vit akademik nga Bordi i Administrimit. Përfituesi i kësaj burse duhet të ruajë një notë mesatare të studimeve në UET së paku 7.00 me qëllim që të përfitojë të njëjtën bursë për vitin pasardhës.


- Bursë Talenti (10 bursa): Individë të dalluar për aftësitë e tyre të talentit në fusha të ndryshme.

- Bursë Pashko (10 bursa): Kryesisht për aplikantë ekselentë në kushte të vështira ekonomike, të cilëve përveç bursës së plotë të studimit, përfitojnë edhe një pagesë mujore për mbulimin e shpenzimeve të jetesës. Numri i bursave Pashko është i kufizuar në 10 të tilla në total, për programet Bachelor. Aplikimi për këtë lloj burse hapet vetëm në rast të krijimit të hapësirave për shkak të diplomimit të studentëve që kanë qenë përfitues të saj, apo të krijimit të vendit vakant për shkak të mosplotësimit të kriterëve të mbajtjes së bursës nga përfituesit ekzistues.

Aplikimet për bursë [formati D.V.1] shqyrtohen nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe procesi monitorohet nga Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Bursave. Skema e akordimit të bursave bëhet publike.

Gjithashtu, mund të akordohen Bursa nga të tretë në bashkëpunim dhe koordinim me UET. UET pranon sponsorizime prej të tretëve si: kompani private, individë të ndryshëm, bamirës, institucione publike brenda dhe jashtë vendit etj., të cilët kërkojnë të mbulojnë shpenzimet e studimit për studentë të caktuar të UET-it, për interes të tyre, të studentëve, ose për interes publik. Në të gjitha këto raste akordimi i këtyre bursave bëhet në bashkëpunim dhe koordinim me UET, përmes nënshkrimit të një Kontrate të veçantë. Të tretët kanë detyrimin që akordimin e bursës ta realizojnë në përputhje me kuadrin ligjor të RSH-së si dhe dhe me Statutin, Rregulloret bazë dhe aktet e tjera rregullatore të UET-it

**(E.3.2/dok.shtesë, pika D.V. 1-4; D.V.9).**



<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MSH "E drejtë publike dhe ndërkombëtare". Ky program ofrohet në gjuhën shqipe. Në lidhje me kriteret e pranimit, kriteret janë të përgjithshme të përcaktuara në dok. Rregullatore UET. Këto procedura dhe kriteret bëhen publiku edhe online duke lehtësuar aksesin në informacion dhe duke e bërë atë publik para fillimit të vitit akademik. Si program studimi i ciklit të dytë, kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë kriteret të përgjithshme dhe nuk ka kriteret të posaçme. UET ka politikën e tij të bursave që aplikon sipas specifikave dhe llojet e bursave që ofrohen. Kategoritë e bursave që ofrohen nga UET janë: bursë e plotë dhe gjysëm bursë.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se, pavarësisht se parashikohet ndjekja e këtij programi studimi nga shtetas të huaj, nuk ka asnjë rregullim se si do të ndiqet ky program studimi nga shtetasit e huaj. Për më tepër programi ofrohet në gjuhën shqipe. GVJ sugjeron që të rishikohet kjo pjesë, ose të shtohen rregulla në lidhje me këtë kategori të mundshme studentësh të huaj që mund të ndjekin këtë program studimi.</i></p> <p><i>Po ashtu, nuk ka rregulla specifike për kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Ndaj si kriter që duhet plotësuar, GVJ sugjeron që në rregulloret të përcaktohen rregulla të veçanta për këto grupe sociale dhe shtresa në nevojë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të</p>	<p>UET vë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e avancimit</p>



plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.

akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, detyrimeve akademike, vlerësimet në lëndë orarin dhe strukturën e vitit akademik, përfitimet dhe mundësitë e studentëve etj përmes informimit nga departamenti në bashkëpunim me strukturat e tjera institucionale. Universiteti ka vënë në dispozicion informacion të nevojshëm në lidhje me studentët dhe pranimin e tyre në çdo fillim viti akademik, mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, mundësitë për transferime kreditesh, planin mësimor të programit të studimit, bursat dhe reduktimin e tarifave, etj. Kështu, në çdo fillim viti akademik, studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, strukturën e vitit akademik, të drejtat dhe detyrimet, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Studentët njihen me rezultatet e tyre vjetore nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS.

UET pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara. Në fillim të vitit akademik organizohet java orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në UET për studentët e rinj, si dhe kurse parapërgatitore ekstra-kurrikulare.

Gjithashtu, në UET organizohet shërbimi i Tutoriatit dhe Këshillimit akademik. Tutoriati dhe këshillimi akademik zhvillohen gjatë gjithë vitit akademik (java e parë e Shtatorit – java e fundit e Qershorit) të shpallur që në fillim të vitit. Çdo anëtar i personelit të brendshëm akademik ka në ngarkim një grup studentësh të cilët këshillohen me pedagogun përkatës në lidhje me lëndët që studenti do të ndjekë, të informohet për detyrimet akademike, politikat dhe procedurat e Universitetit, si edhe për mundësitë e shërbimit që ofrohen në UET, për të përmbushur me sukses të gjitha detyrimet për diplomimin e tij. Po ashtu, Këshillimi akademik mundëson që çdo pedagog, në zyrën e caktuar 1 (një) orë në javë, jashtë orarit të mësimin, është në dispozicion të studentëve që ndjekin lëndën e tij për shpjegime apo sqarime të nevojshme.

	<b>(E.7, pika 2; E.10.2-10.5; E.27.2; E.28, pika D.II).</b>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UET ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme të cilat u bëhen me dije studentëve të interesuar dhe janë pjesë e Broshurës së Dokumenteve UET. Studentëve të regjistruar në këtë program studimi mund t'u njihen kredite të fituara në programe të tjera studimi në fusha të njëjta ose të përafërta, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren përkatëse të transferimeve në UET. Njohja dhe vlerësimi me kredite bazohet në parimet, kriteret dhe instrumentet e Konventës së Lisbonës për Njohjen, duke pranuar parimin e diversitetit të programeve. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, vetëm në fillim të vitit akademik. Studenti ka të drejtë të transferojë vetëm lëndë të vlerësuara me notë përfundimtare kaluese. Në rast njohjeje studenti bart notën me të cilën është vlerësuar në programin e mëparshëm të studimit. Nga kjo klauzolë përjashtohen studentët që transferojnë studimet brenda UET-së të cilëve u njihet e drejta e riprovimit për lëndët në provimin e të cilave nuk janë paraqitur ose kur janë vlerësuar me notë jokaluase. Në çdo rast studenti duhet të ndjekë në UET së paku një vit akademik. Studenti duhet të fitojë përmes programit të UET jo më pak se 25% të ECTS në kategoritë e lëndëve A-D, si dhe të përmbushë detyrimet përmblyëse (Kategoria E) të programit të studimit. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes i departamentit. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me Departamentin, informojnë studentët dhe bëjnë vlerësimet paraprake për studentët e interesuar për të transferuar studimet. Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në UET, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve. <b>(E.3.2/dok.shtesë; E.7, pika 9; E.28).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Njohuritë e përfituara nga studentit kontrollohen dhe vlerësohen me pikë përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimi në auditor, provimeve me shkrim, eseve/detyrave të kursit, që zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike në fillim të vitit akademik si dhe secili pedagog në fillim të lëndës, dhe që janë të detyrueshme për zbatim. Informacion i qartë jepet po</p>

	<p>ashtu nga titullari i lëndës dhe në syllabusin e saj. Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi. Këshillimi akademik si veprimtari jashtë auditorit, në shërbim të studentëve, bën të mundur që pedagogët të qëndrojnë në dispozicion të studentëve për t'i këshilluar, për t'i ndihmuar në përfundimin me sukses dhe në kohën e duhur të detyrimeve akademike. Grafiku i organizimit të këtij shërbimi publikohet në fillim të çdo semestri. (E.7; E.19).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>UET informon studentët në lidhje me kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimin e tyre, cilësinë e mikrotezës dhe elementët dhe strukturën e saj, etj. Në përfundimit të studimeve, studenti mbron temën e diplomës para komisionit të ngritur për këtë qëllim. Diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome, i cili është produkt krijues dhe me origjinalitet i studentit; mund të ketë karakter teorik ose empirik. Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë (B.II). Zgjedhja e temës dhe puna për shkrimin e punimit të diplomës nis që në fillim të vitit të parë akademik. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallura për këtë qëllim. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike dhe pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit. Kalendari akademik parashikon 4 (katër) sezone për mbrojtjen e diplomës, të cilat janë: (1) Java e 1- rë e tetorit (2) Java e 2- të e nëntorit (3) Java e 1- rë e marsit (4) Java e 3-të e korrikut. Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës, studenti duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome. Në përfundim të programit të studimit dhe pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, studentu pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj.</p> <p>(E.7, pika 8; E.10; E.10.1-10.5; E.15.1-15.4).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në</p>	<p>Për programet e ciklit të dytë UET organizon informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe individëve të tjerë të</p>

<p>mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>interesuar për të ndjekur programet Master. Kjo realizohet nëpërmjet këtyre formave:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Organizim, në mjediset e UET, i takimeve informuese, sqaruese, dhe ndërgjegjësuere me grupe studentësh që shfaqin prirje për vijimin e studimeve në ciklin e dytë;</li> <li>Takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve;</li> <li>Përgatitje e materialeve informuese – sqaruese – ndërgjegjësuere si: fletëpalosje, postera, broshura etj., dhe të atyre vizive si: spote televizive, mesazhe promocionale etj;</li> <li>Organizim logjistik, orientues, me mbështetje brenda burimeve njerëzore të UET-it të “Javëve të regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve për ciklin e dytë, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës;</li> </ol> <p>Po ashtu, UET merr pjesë në Panairët e Punës për t’iu bërë të njohur maturantëve programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t’i ndihmuar ata të bëjnë në zgjedhjen e programeve të studimit të UET ofron. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni u vë në dispozicion studentëve dhe të interesuarve informacion në lidhje me këtë program studimi, apo informon të interesuarit përmes takimeve të ndryshme në lidhje me programin e studimit. Po ashtu ky informacion jepet edhe përmes faqes zyrtare të internetit të universitetit. Po ashtu në çdo fillim viti/semestri me anë të pedagogëve gjatë Javës së Orientimit, orientohen dhe informohen studentët në lidhje me planin mësimor, lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj.</p> <p><b>(E.3.2/dok.shtesë, D.I; E.17; E.27.1).</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në këtë program studimi. UET informon studentët në lidhje me kriteret e punimit të diplomës dhe diplomimin e tyre, cilësinë e mikrotezës dhe elementët dhe strukturën e saj, etj. Në përfundimit të studimeve, studenti mbron temën e</i></p>

	<i>diplomës para komisionit të ngritur për këtë qëllim. Në përfundim të programit të studimit dhe pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj. Për programet e ciklit të dytë UET organizon informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe individëve të tjerë të interesuar për të ndjekur programet Master.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studenti ka të drejtë të informohet mbi programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen e tij, kohëzgjatjen e këtij programi, lëndët/modulet që zhvillohen, syllabuset e tyre, njihet me detyrimet semestrale dhe vjetore, strukturën akademike, etj. Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet: Këshillimit me stafin akademik; Zyra e Kujdesit ndaj Studentit; Rregullores mësimore të programit të studimit; kontratës që nënshkruhet me UET. UET, ka ndërtuar aplikacionin UET LMS, gjë që u jep mundësinë studentëve të informohen rreth orarave të leksionit, notave të marra në provim, mungesat që kanë kryer dhe cdo njoftim tjetër që i shërben studentit, duke filluar nga ndryshimet e orareve të leksioneve deri tek zëvendësimi i aktiviteteve. Website Universiteti Europian i Tiranës, nëpërmjet faqes zyrtare të tij, azhuron informacione të detajuara dhe të dhëna që i vijnë në ndihmë studentëve aktual dhe atyre potencial për studimet Bachelor dhe Master. (E.3.2/dok.shitesë, pika D.I.2; E.7; E.17; E.51).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të	UET i mundëson studentëve të këtij program informacion të nevojshëm ku studentët njihen më gjerësisht me programin që do të ndjekin, strukturën dhe përmbajtjen e tij, lëndët që do të zhvillojnë, mundësitë që ofron ky program studimi, rregullat për



<p>posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>frekuentimin dhe vlerësimin, praktikën mësimore, diplomimin, etj. Po ashtu Departamenti në çdo fillim viti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit, jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin, etj. Syllabuset janë të vlefshme për studentët në hard copy por edhe elektronikisht dhe përmbajnë literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar si dhe elementë të nevojshëm për lëndën dhe detyrimet akademike që lidhen me të. Përdorimi i platformës LMS ka sjellë facilitete në këtë komunikim dhe shkëmbim informacioni të shpejtë. (E.7; E.17; E.19).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për mundësitë për trajnime, pjesëmarrje në programe shkëmbimi për studentë, mundësi internshipi dhe punësimi, etj. me qëllim motivimin personal dhe orientimin sa më të mirë në tregun e punës. UET mbështet dhe orienton studentët në lidhje me qartësimin dhe njohjen e objektivave të programeve master që ofron dhe mundësitë/avantazhet e këtyre programeve për studentet që do t'i ndjekin ato, karrierën e tyre profesionale dhe orientimin më të mirë në tregun e punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit. Zyra e këshillimit dhe karrierës ka një rol të rëndësishëm në mbështetjen e të sapodiplomuarve që bëjnë përpjekjet e para për t'u integruar shpejt në tregun e punës. Agjenda e kësaj zyre ka për qëllim rritjen e perspektivave të tyre të ardhshme dhe të mbështesë avancimin më tej të karrierës së re. Gjithashtu UET çdo vit zhvillon Panairin e Punës, përgjatë të cilit studentët njihen me ofertat për punësim dhe internship të studiove ligjore, zyrave të avokatisë, zyrave të konsulencës, si dhe mundësinë e intership në institucionet publike, ku UET ka marrëveshje bashkëpunimi, si Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, etj. Po ashtu Bordi i Tregut të Punës si organ këshillues pranë departamentit japin kontributin e tyre në lidhje me orientimin më të mirë të programit të studimit me tregun e punës si dhe në kryerjen e praktikave/stazheve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me daljen e studentëve në tregun e punës.</p> <p>(E.2, neni 18; E.12; E.12.1-12.5; E.17).</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Në çdo fillim viti akademik UET zhvillon javën e orientimit për informimin mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, etj.</p> <p>Departamenti në bashkëpunim me njësi/struktura të tjera informon studentët mbi programin e studimit që ata ndjekin, të drejtat dhe detyrat, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, sezonet e provimeve etj. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit është njësi e posaçme në UET që shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit; ndihmon studentët të përfshihen në jetën e kampusit, në lidhje me politikat e Universitetit; ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore; zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit, etj.</p> <p>Po ashtu, përveç stafit akademik edhe stafi ndihmës-akademik dhe ai administrativ, për detyrat dhe përgjegjësitë që mbulojnë duhet të ndihmojnë, mbështesin dhe informojnë studentët (p.sh. sekretaria, shërbimi i IT-së, financës).</p> <p>Një nga detyrat e koordinatorës së departamentit është mbajtja e kontakteve të rregullta, njoftimeve elektronike dhe me telefon, me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS. (E.9, pika E.I.6; E.12; E.27.2).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit</p>	<p>Informacioni në lidhje me këtë program studimi mundësohet përmes mënyrave të ndryshme dhe është edhe i aksesueshëm online, në web site e institutit, përmes sistemit të brendshëm LMS, që mundëson një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit.</p>

<p>dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Ky informacion është lehtësisht i arritshëm dhe ndihmon studentët në informimin në kohë dhe të duhur në lidhje me programin e studimit. Për studentët, sekretaria mësimore dhe departamenti kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave për secilin prej tyre dhe koordinimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera në funksion të tij. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave personale të studentit, rekordeve akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: programet e studimit, orarin mësimor, fondin e librave të Bibliotekës, etj.</p> <p>UET LMS (Learning Management System) është një platformë në rrjet, e bazuar tek Moodle, e cila u krijon akses studentëve tek materialet e lëndëve që vendosen online nga pedagogu, si edhe për të përdorur disa mjete të ndryshme me synim përmirësimin e mësimnxënies. Është një program kompjuterik që përdoret për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen elektronike të materialeve të ndryshme që përdoren për zhvillimin e lëndëve, pjesë e programeve të studimit në UET. Platforma u krijon mundësi pedagogëve dhe studentëve të ndërveprojnë përmes internetit si të ishin në auditor. Parimet kryesore ku bazohet përpunimi i të dhënave personale janë: konfidencialiteti, siguria e informacionit, integriteti, disponueshmëria dhe përditësimi i të dhënave personale.</p> <p>Çdo student ka adresën e tij të e-mailit ku logohet në domain e universitetit, dhe në momentin e regjistrimit, pajiset nga Zyra e IT, me një adresë e-maili të UET. Kjo u mundëson studentëve që të marrin të gjitha informacionet që dërgohen nga koordinatori dhe departamenti dhe informacione të tjera që janë të vlefshme përmes këtij sistemi dhe aksesohen nga studentët.</p> <p><b>(E.2, neni 53; E.3.2/dok.shtesë, pika E.VI; E.9).</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Studenti informohet mbi programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen e tij, kohëzgjatjen e këtij programi, lëndët/modulet që zhvillohen, syllabuset e tyre, njihet me detyrimet semestrale dhe vjetore, strukturën akademike, etj. Informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të</i></p>

	<p><i>studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet: Këshillimit me stafin akademik; Zyra e Kujdesit ndaj Studentit; Rregullores mësimore të programit të studimit; kontratës që nënshkruhet me UET. Për studentët, sekretaria mësimore dhe departamenti kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave për secilin prej tyre dhe koordinimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të tjera në funksion të tij.</i></p> <p><i>UET, ka ndërtuar aplikacionin UET LMS, gjë që u jep mundësinë studentëve të informohen rrethë orarave të leksionit, notave të marra në provim, mungesat që kanë kryer dhe çdo njoftim tjetër që i shërben studentit. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave personale të studentit, rekordeve akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: programet e studimit, orarin mësimor, fondin e librave të Bibliotekës, etj.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Referuar RVB, për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me cilësinë në hyrje dhe dalje, punësimin gjatë dhe pas diplomimit, etj. Të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për programin e studimit. UET disponon statistika mbi numrin e të diplomuarve në programin e studimit MSH “E drejtë publike dhe ndërkombëtare”. Në dokumentat e parqitur përcaktohet se të dhënat merren nga raportet e gjurmimit të punësimit të studentëve të diplomuar për çdo vit akademik, që kryhet nga Zyra UET Alumni.

	<p>Sipas të dhënave institucionale, për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 48 studentë në këtë program studimi. Nr. i të diplomuarve në përputhje me diplomën është 10 dhe në përqindje 25%. Por në tabelën e paraqitur për këtë qëllim nuk ka informacion të përditësuar në lidhje me vitet e tjera akademike (Tabela 29). (E.29; E.38).</p>																																									
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore mbi regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, shkallën e punësimit për këtë program studimi. Sistemi UMIS mundëson që të dhënat statistikore të përpunohen në çdo kohë. Kështu, sipas të dhënave institucionale, dhe vizitës në institucion, numri i studentëve të regjistruar transferuar sipas profileve është si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="579 842 1394 1518"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Programi/profili</th> <th>Te regjistruar për herë të parë</th> <th>Të transferuar</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="2">19-20</td> <td>E Drejtë Penale</td> <td>27</td> <td>3</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Publike dhe Kushtetuese</td> <td>7</td> <td>7</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">20-21</td> <td>E Drejtë Penale</td> <td>30</td> <td>4</td> <td>34</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Publike dhe Kushtetuese</td> <td>7</td> <td>7</td> <td>14</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">21-22</td> <td>E Drejtë Penale</td> <td>30</td> <td>1</td> <td>31</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Publike dhe Kushtetuese</td> <td>7</td> <td>3</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">22-23</td> <td>E Drejtë Penale</td> <td>23</td> <td>3</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>E Drejtë Publike dhe Kushtetuese</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>(E.27; Minutat e Vizitës në UET).</p>	Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali	19-20	E Drejtë Penale	27	3	30	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	7	7	14	20-21	E Drejtë Penale	30	4	34	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	7	7	14	21-22	E Drejtë Penale	30	1	31	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	7	3	10	22-23	E Drejtë Penale	23	3	26	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	2	3	5
Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali																																						
19-20	E Drejtë Penale	27	3	30																																						
	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	7	7	14																																						
20-21	E Drejtë Penale	30	4	34																																						
	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	7	7	14																																						
21-22	E Drejtë Penale	30	1	31																																						
	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	7	3	10																																						
22-23	E Drejtë Penale	23	3	26																																						
	E Drejtë Publike dhe Kushtetuese	2	3	5																																						
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të</p>	<p>UET disponon statistika mbi ecurinë e studentëve të këtij programi, që nga pranimi deri në diplomim. Këto të dhëna bëhen pjesë e raporteve të ndryshme që hartohen si në nivel njësie ashtu edhe në raportin vjetor institucional, si dhe janë pjesë e raportimeve periodike/vjetore. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit,</p>																																									

<p>verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj.</p> <p>Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS.</p> <p><b>(E.38; E.46; Tabelat përmbledhëse – Aneks RVB).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. UET ka investuar në sisteme, të cilat e mbështetin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS), bëhet e mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio-vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët, si dhe kolegët e kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët on-line kudo që ndodhet.</p> <p>Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat e studentëve për programin e studimit dhe informacioni menaxhohet dhe ruhet në database e sekretarisë (sistemi i brendshëm). Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në proces-verbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve. Në përfundim ato depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. Të dhënat e studentëve janë të pasqyruara në: Regjistrin themeltar, në Regjistrin e rezultateve akademike të studentit si dhe në Regjistrin e Diplomave. Këto të dhëna janë edhe në database përkatës. Studentët lehtësisht mund të njihen me vlerësimet që lëndë përmes aksesit në informacionin/njoftimet që lidhen me sistemin UMIS e që administrohen nga Zyra e IT-së. Gjatë vizitës në UET, GVJ konstatoi disa parregullsi në lidhje me sekretarinë mësimore, në regjistrat që administrojnë sekretaria mësimore. GVJ rekomandon plotësimin me korrektesë, saktësi dhe në kohë të rubrikave të regjistrave që administrojnë sekretaria mësimore (Regjistrin themeltar, Regjistrin e rezultateve akademike të studentit si dhe Regjistrin e Diplomave). Po ashtu, rekomandohet</p>

	<p>të bëhet kujdes në plotësimin e të dhënave në këto regjistra, si dhe të evitohen korrigjimet.</p> <p><b>(E.2, neni 53.1; E.9; E.42.1; E.46; Minutat e Vizitës në UET).</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raportet analitike si rregull janë periodike/vjetore dhe në të jepen të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me veprimtarinë e departamentit dhe njësive të tjera të UET-së, performancën, të dhëna mbi studentët, aktivitetet dhe veprimtaria shkencore, ngarkesa mësimore e pedagogëve, publikimet, bashkëpunimet dhe partneritetet, etj. Po ashtu, mund të hartohen edhe analiza dhe raporte të tjera p.sh. analizë e tregut të punës, etj.</p> <p>Të dhënat nga këto raporte analitike shërbejnë më pas për vlerësimin e performancës dhe identifikimin e nevojave për përmirësim. Departamenti analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësisimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Nga vlerësimi i dokumentave të paraqitur nga UET, rezulton se në lidhje me të dhënat, në disa raste ato janë të pa përditësuar (p.sh. tabela 29 mbi diplomimin e studentëve, tabela 28.1. mbi projektet, etj).</p> <p><i>GVJ rekomandon që këto të dhëna të azhurnohen dhe përditësohen; si dhe të saktësohet terminologjia në disa dokumenta (p.sh. në disa dokumente përmendet një program tjetër studimi, ose referenca lidhet me një program tjetër studimi MSH).</i></p> <p><b>(E.17; E.28.1; E.29; E.38; Tabelat përmbledhëse – Aneks RVB).</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET disponon dhe mban, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme/statistika në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Mbi bazën e këtyre të dhënave hartohen raporte të ndryshme. Raportet analitike si rregull janë periodike/vjetore dhe në të jepen të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me veprimtarinë e departamentit dhe njësive të tjera të UET-së, performancën, të dhëna mbi studentët, aktivitetet dhe veprimtaria shkencore, ngarkesa mësimore e pedagogëve, publikimet, bashkëpunimet dhe partneritetet, etj. Nga vlerësimi i dokumentave të paraqitur</i></p>

	<p>nga UET, rezulton se në lidhje me të dhënat, në disa raste ato janë të pa përditësuara (p.sh. tabela 29 mbi diplomimin e studentëve, tabela 28.1. mbi projektet, etj).</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> që këto të dhëna të azhurnohen dhe përditësohen; si dhe të saktësohet terminologjia në disa dokumenta (p.sh. në disa dokumente përmendet një program tjetër studimi, ose referenca lidhet me një program tjetër studimi MSH).</p> <p>Po ashtu, një vërejtje GVJ bën në lidhje me sekretarinë mësimore. Nisur nga disa pasaktësi/parregullsi në regjistrat që administrojnë sekretaria mësimore, të vërejtura gjatë vizitës në institucion, GVJ rekomandon plotësimin me korrektesë, saktësi dhe në kohë të rubrikave të regjistrave që administrojnë sekretaria mësimore (Regjistrin themeltar, Regjistrin e rezultatve akademike të studentit si dhe Regjistrin e Diplomave). Po ashtu, rekomandohet të bëhet kujdes në plotësimin e të dhënave në këto regjistra, si dhe të evitohen korrigjimet.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Sipas akteve rregullatore të UET-së (<i>Statut, Rregullore</i>), përfshirja dhe angazhimi i studentëve bëhet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera në fuqi. Në UET, studentët marrin pjesë në: Senat, Këshilla Studentorë, Komisionet e përhershme në nivel universiteti sipas përcaktimeve statutore.</p> <p>UET garanton pjesëmarrje reale të studentëve kryesisht në përfaqësimin e tyre në këto organe kolegjiale (Senat, KSBC, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve) si dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përmes pyetsorëve, fokus-grupeve, përfaqësimit studentor në forume apo organizime studentore për të përcjellë zërin e</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose</p>	



<p>përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>studentëve, mbledhjet e hapura të departamentit, ku një herë në muaj ftohen edhe studentët. Këto përfaqësime janë reale dhe konkrete. Po ashtu, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit mbështet studentët për qeverinë studentore, programet e ndryshme të lidhshpimit të studentëve, etj. <b>(E.2, nenet 16, 19, 51; E.5, neni 42; E.12)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Institucioni mban parasysh në hartimin apo ndryshimet e mundshme të programit, ngarkesën e studentëve brenda dhe jashtë auditorit, duke bërë një shpërndarje të kësaj ngarkese mes punës në auditor dhe jashtë tij për secilën lëndë, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Si pjesë e komisioneve/organeve kolegjiale bazuar në përcaktimet statutores studentët kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së programit, duke dhënë kështu kontributin e tyre me vlerë në të gjitha këto organe kolegjiale ku bëjnë pjesë.</p> <p>Sugjerimet dhe kontributi i studentëve merret edhe në nivel departamenti, në mënyrë të dpd për programin konkret të studimit që ata ndjekin dhe që bëhen pjesë e raporteve që hartohen nga KSBC dhe që u shërben më tej njësive bazë për analiza dhe për të adresuar problematikat e hasura. Zhvillimi i fokus grupeve, pyetësorëve online dhe mbledhjeve të hapura të departamenteve shërbejnë si instrumente për të matur perceptimin e studentëve në raport me programin e studimit në tërësi dhe këto bëhen pjesë e trajtimeve dhe diskutimeve në departament apo edhe në struktura të tjera të universitetit.</p> <p><b>(E.2; E.5; E.30; E.30.1; E.30.15).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe</p>	<p>Studentët marrin informacione të vazhdueshme nga pedagogu/ët i lëndës dhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, si: vlerësimi i provimit të ndërmjetëm, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi dhe vlerësimi përfundimtar. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent.</p> <p>Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit</p>

<p>reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>në tezë si dhe ka të drejtën e ankimimit. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka bërë korigjimin dhe në procesverbalin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, brenda të cilave përfshihen edhe seancat sqaruese, ku pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore. Struktura e programit i bëhet me dije studentëve që në fillim të regjistrimit dhe në fillim të çdo semestri studentët njihen në platformën LMS me syllabuset e lëndëve që frekuentojnë duke siguruar transparencë dhe qartësinë e programit. (E.7; E.19; E.38; E.40; E.40.1)</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Sipas akteve rregullatore të UET-së (Statut, Rregullore), përfshirja dhe angazhimi i studentëve bëhet në përputhje me LAL dhe aktet e tjera në fuqi. UET garanton pjesëmarrje reale të studentëve kryesisht në përfaqësimin e tyre në këto organe kolegjiale (Senat, KSBC, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve) si dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përmes pyetsorëve, fokus-grupeve, përfaqësimit studentor në forume apo organizime studentore për të përcjellë zërin e studentëve, mbledhjet e hapura të departamentit, ku një herë në muaj ftohen edhe studentët. Këto përfaqësime janë reale dhe konkrete.</i></p> <p><i>Si pjesë e komisioneve/organeve kolegjiale bazuar në përcaktimet statutoare studentët kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së programit, duke dhënë kështu kontributin e tyre me vlerë në të gjitha këto organe kolegjiale ku bëjnë pjesë</i></p>

	<i>Po ashtu, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit mbështet studentët për qeverinë studentore, programet e ndryshme të lidërsipit të studentëve, etj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Departamenti në bashkëpunim me njësi/struktura të tjera informon studentët mbi programin e studimit që ata ndjekin, të drejtat dhe detyrat, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, sezonet e provimeve etj.  Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit është njësi e posaçme në UET që shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit; ndihmon studentët të përfshihen në jetën e kampusit, në lidhje me politikat e Universitetit; ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore; zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit, etj. Po ashtu, përveç stafit akademik edhe stafi ndihmës-akademik dhe ai administrativ, për detyrat dhe përgjegjësitë që mbulojnë duhet të ndihmojnë, mbështesin dhe informojnë studentët (p.sh. sekretaria, shërbimi i IT-së, financës). (E.9; E.12; E.27.2).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët	Referuar DVV, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, sikurse ruan edhe kontaktet pas diplomimit, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim plotësohet me

<p>në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, praktikën profesionale, bursat, stazhe, internshipe, dhe orientim në tregun e punës. Duke krijuar një kulturë shërbimi cilësor dhe mësimdhënie bashkohore synohet përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve nëpërmjet informimit, këshillimit, si dhe orientimit të tyre.</p> <p><b>(E.12; E.27.2).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës ndjek studentët pas diplomimit të tyre. Ajo gjurmon studentët pas diplomimit dhe përpunon statistika mbi Alumnin; sa integrohen në tregun e punës, vazhdojnë studimet, etj. Kjo zyrë administron dhe database me burime të mundësive të ndryshme për punësim, internship, bursa studimi, etj, duke i shpërndarë njoftimet tek studentët të cilët mund të kenë interes. Që nga viti 2009 në UET është ngritur edhe shoqata Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë. Në këtë kuadër, studentë Alumni janë të përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamentit. Këto të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve të saj bëhen pjesë edhe e raporteve dhe informacioneve që iu përcillen organeve/autoriteteve drejtuese të universitetit apo edhe në rast raportesh për agjensi të tjera në arsimin e lartë. Zyra e këshillimit të karrierës ka një rol të rëndësishëm në mbështetjen e të sapodiplomuarve që bëjnë përpjekjet e para për t’u integruar në tregun e punës. Agjenda e kësaj zyre ka për qëllim rritjen e perspektivave të tyre të ardhshme dhe të mbështesë avancimin më tej të karrierës së re. Ajo ç’ka synohet është ruajtja e lidhjeve të krijuara gjatë viteve të studimit, rivendosja e lidhjeve të vjetra ose krijimi i lidhjeve të reja. Nisur nga kjo, zyra e Alumnit, vazhdon të mbajë kontakte të përhershme me të diplomuarit, ku një nga pikat e kontaktit lidhet me ecurinë e karrierës së tyre, punët e reja etj, me qëllim për t’i ndihmuar ata, si dhe të bashkëpunojë me ta për të promovuar interesa të përbashkëta. Me synim këshillimin e</p>

	<p>karrierës dhe informimin e maturantëve, gjithashtu krijimin e urave të bashkëpunimit mes botës së biznesit, universitetit dhe studentëve, UET zhvillon “Javën e Hapur”, që karakterizohet nga një dinamike me aktivitete. Gjithashtu UET çdo vit zhvillon Panairin e Punës, përgjatë të cilit studentët njihen me ofertat për punësim dhe internship të studiove ligjore, zyrave të avokatisë, zyrave të konsulencës, si dhe mundësinë e intership në institucionet publike, ku UET ka marrëveshje bashkëpunimi, si Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Drejtoria e Burgjeve etj. (E.12; E.12.2; E.17; E.27.2).</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UET ka procedura e struktura të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave. Këto struktura ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, sikurse ruan edhe kontaktet pas diplomimit, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim plotësohet me këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Veprimtaria e UET mbështetet nga strukturat akademike dhe administrative të tij, sipas detyrave dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të funksionimit të tij. UET ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike, në përmbushje të standardeve të kërkuara. Institucioni monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve. Këto vlerësime duhet të çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre programeve. Përmes dokumentave të hartuar, përcaktohen formatet dhe mënyrat e hartimit të syllabuseve, të vlerësimeve të ndryshme, të përdorimit të platformës Learning Management System, si dhe organizohen trajnime të personelit akademik, duke synuar kështu metoda inovative të mësimdhënies.</p> <p><b>(E. 30.2; E. 30.3; E.46.1; E.46.2; E.46.3).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Vlerësimi i procesit të mësimdhënies realizohet, në mënyrë periodike gjatë vitit. Ky vlerësim synon përmirësimin dhe rritjen e cilësisë të procesit të mësimdhënies. Procesi i vlerësimit realizohet nëpërmjet metodave direkte dhe të tërthorta të tilla si pyetësorët që ruajnë anonimatit e studentëve, focus grupet, ndjekja e mësimdhënies në auditor nga drejtuesi i departamentit ose një profesor i fushës, etj, për të gjitha lëndët dhe personelin akademik që aktivizohet në këtë program studimi.</p> <p>UET ka tashmë të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) konform kërkesave të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimit e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të UET-së. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetet në garantimin e pjesëmarrjes së personelit akademik dhe të studentëve në procesin e vetëvlerësimit dhe në përfitimin prej ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë. <b>(E.30 – E.30.6; E.46.1; E.46.2; E.46.3).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike cilësinë, përmes instrumentave të adoptuar për këtë qëllim, duke përfshirë këtu edhe studentët. UET synon përmirësimin e vazhdueshëm të</p>

<p>periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>cilësisë së mësimdhënies. Për këtë, institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik, të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Studentët kryejnë vlerësimin çdo fund semestri nëpërmjet sistemit LMS, duke ruajtur anonimat e tyre si dhe nëpërmjet fokus-grupeve. Gjithashtu, studentët bëhen pjesë e mbledhjeve të hapura të Departamentit, ku mund të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre, në lidhje me procesin e mësimdhënies apo shqetësime të tjera që mund të ngrihen. (E.4; E.7.2; E.30 – E.30.9).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Politika për sigurimin e cilësisë e UET-së është transparente dhe ndikon në punën e përditshme të vlerësuesve dhe në cilësinë e raporteve të vlerësimit që ata hartojnë. Hartimi dhe ndryshimi i politikës për sigurimin e cilësisë është po ashtu një proces gjithëpërfshirës, i hapur dhe transparent për të interesuarit, përfshi edhe studentët. Rezultatet e vlerësimit që merren përmes instrumentave që aplikohen përpunohen nga KSBC, nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online dhe më pas i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Drejtuesi i Departamentit. Më pas, Departamenti analizon rezultatet dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme. (E. 30.13; E. 30.15; E.30.16)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Politika për sigurimin e cilësisë është një proces që përfshin: rishikimin, përditësimin e parimeve, të standardeve, të treguesve, përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimin dhe përmirësimin e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit. Në këtë proces, institucioni synon të promovojë praktikën e mira dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Të dhënat e përftuara nga vlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situatës, por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. (E. 7.2; E. 30.13; E. 30.15; E.30.16).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike, në përmbushje të standardeve të kërkuara. UET monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve.</i></p>

	<i>Institucioni garanton edhe përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik, të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Këto vlerësime shërbejnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, si dhe të promovohen praktikatat e mira dhe përmirësimi i mëtejshëm i mësimdhënies.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UET ka tashmë të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe ka adoptuar procedurat dhe instrumentat përkatës për këtë qëllim. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) është organ kolegjal, autonom, që vepron në nivel institucioni dhe është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Kjo njësi vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Programet e studimit që ofrohen në nivel njësie bazë/kryesore rishikohen në nivel të brendshëm të kësaj njësie për t'i përshtatur ato me nevojat specifike të këtij program studimi dhe me nevojat e tregut të punës. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë synon garantimin e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të UET. (E.2, neni 16; E.5, neni 6.1, pika 2; E.8; E.30.1).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e	UET ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron. Sigurimi i cilësisë është pjesë e politikave dhe strategjisë së përgjithshme të zhvillimit institucional. Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë: Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET. a) Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për



<p>vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikën e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit. b) Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, funksionon në nivel institucional, dhe bën vlerësimin e efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. (E.2, neni 16; E.5, neni 6.1, pika 2; E.8; E.30.1).</p>
<p><b>Kriteri 3. Institucioni</b> përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Në UET, sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. KSBC-ja, si strukturë e dedikuar, mban komunikim të rregullt me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe Kryetari i KSBC-së është njëkohësisht edhe koordinatori institucional i UET për marrëdhëniet me ASCAL-in. KSBC-ja ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e Institucionit. Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike. Për këtë qëllim, institucioni bashkëpunon ngushtë me ASCAL. Rezultatet e KSBC publikohen përmes raporteve që i dërgohen Rektorit, Administratorit të UET, si dhe raporteve përkatëse që i dërgohen Dekanit dhe Përgjegjës të Departamentit.</p> <p>KSBC-ja krijon dhe mban në vijimësi marrëdhënie me institucione pjesëmarrëse në Rrjetin Europian të Sigurimit të Cilësisë, të cilat pas vendimit të Rektoratit, mund të ftohen të zhvillojnë kontrollin e jashtëm të UET. Aktualisht UET ka akreditim institucional si dhe ka të akredituar programet e studimit që ofron përfshin dhe këtë program studimi. Gjithashtu, UET ka marrë edhe akreditim institucional 5 vjeçar nga Quality Assurance Agency for Higher Education (QAA).</p> <p>(E.8; E. 30.3; E.18; E.54.3 – 54.8).</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>UET ka përcaktuar përgjegjësitë funksionale të strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha nivelet. Ato kanë lirinë dhe autoritetin të identifikojnë problemet, të marrin nisma nëpërmjet hartimit të plan-veprimeve, të japin rekomandime dhe të paraqesin zgjidhje për çështje të cilësisë. UET i përmbahet Standardeve të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të zbatueshme në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (ESG), të miratuara nga Konferenca Ministeriale (Maj, 2015). Nëpërmjet strukturave të brendshme të Universitetit, është vënë në funksion një sistem që ofron performancë dhe i përgjigjet pyetjeve mbi saktësinë dhe eficientësinë e procedurave të sigurimit të cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin. Fusha të vlerësimit të brendshëm në kuadër të sigurimit të cilësisë janë: - Programet e studimit dhe mësimdhënia - Studentët dhe arritjet e tyre - Personeli dhe performanca e tij - Kërkimi shkencor - Shërbimet për studentët - Menaxhimi i Institucionit. <b>(E.8; E. 30.3).</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET ka të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe ka adoptuar procedurat dhe instrumentat përkatës për këtë qëllim. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin. Fusha të vlerësimit të brendshëm në kuadër të sigurimit të cilësisë janë: Programet e studimit dhe mësimdhënia; Studentët dhe arritjet e tyre; Personeli dhe performanca e tij; Kërkimi shkencor; Shërbimet për studentët; Menaxhimi i Institucionit. Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet vjetore periodike i përcillën rektoratit të UET-së për hartimin e raportit vjetor institucional. KSBC harton një raport vjetor institucional ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruara për studentët si dhe rekomandon masa për përmirësimin e cilësisë. Ky raport i paraqitet Senatit Akademik. Në përfundim të çdo viti akademik, UET harton raportin e veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore mbi analizën e programeve të studimit, ku përfshihet edhe ky program studimi që po riakreditohet. Ky raport miratohet nga senati akademik i UT, dhe gjithashtu i dërgohet MASR.</p> <p>UET me qëllim vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të studentëve, zhvillon anketime/pyetsorë me studentët duke ruajtur anonimatin. Po ashtu këto pyetsorë shërbejnë edhe për të marrë mendimin dhe feedback-un e studentëve për programin përkatës të studimit që ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij; zhvillon fokus-grupe me studentë si dhe vlerësime të ndryshme të stafit akademik dhe ndihmës akademik si dhe të shërbimeve që ofron institucioni. Të gjitha këto të dhëna përpunohen dhe përmbledhen në formën e një raporti periodik vlerësimi mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel institucional dhe në nivel departamenti. <b>(E.8; E.17; E. 30.3).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim</p>	<p>Raporti i vlerësimit përpilohet në fund të vitit akademik dhe paraqet të gjitha rezultatet e agreguara. Në mënyrë periodike, KSBC informon njësinë kryesore dhe përgjegjësin e departamentit rreth rezultateve të dala, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së njësive dhe stafit akademik në të ardhmen. Në përfundim të këtij procesi, hartohet një raport vjetor që analizon dhe bën një vlerësim të brendshëm të institutit dhe të programit të studimit, përkundëjt standardeve shtetërore të cilësisë. KSBC dhe</p>

<p>të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive. Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë.</p> <p>Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve të parashikuara në aktet e UET-së përdoren për: përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm; për akreditimin; për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit; për planifikimin vjetor dhe strategjik të UET-së; për përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. <b>(E.8; E.17; E. 30.3).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UET në kuadër të vlerësimit, të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor disa metoda të drejtpërdrejta. Impakt të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin mendimet e studentëve të shprehura në pyetësorët që organizohen për këtë qëllim në fund të çdo semestri, nga ku merret mendimi i studentëve mbi programin e studimit në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog që angazhohet në auditor në procesin e mësimdhënies, cilësinë e mësimdhënies dhe syllabuset, etj. Institucioni përdor disa metoda të dpd, si: teste të standardizuara; dëgjime në auditor (veçanërisht për stafin e ri të kategorisë lektor/asistent-lektor); vlerësimi me pikë; testime paraprake dhe përfundimtare; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vlerësim i praktikës. Të dhënat e përfuara nga sa më sipër, pas përpunimit statistikor dhe cilësor, shfrytëzohen në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të kurseve që ofrohen. Në raportet vjetore të njësisë evidentohen dhe rezultatet e vlerësimit për programin që dalin nga format e ndryshme direkte dhe indirekte të vlerësimit të mësimdhënies. Departamenti bashkëpunon me KSBC në këtë drejtim. GVJ gjatë vizitës në institucion u njoh me këtë proces vlerësimi dhe diskutoi për aspekte të caktuara të vlerësimit mbi cilësinë e programit të studimit që është objekt i këtij akreditimi.</p> <p><b>(E.30.8; E.40; E.40.1; E.41; Minutat e vizitës në UET).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>Institucioni nëpërmjet KSBC-së përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe/pyetësorë të studentëve që ndjekin</p>

<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>programet e studimeve apo të diplomuar; pyetsorë/sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës etj; raport vetvlerësimi nga stafi akademik i përfshirë në programin e studimit. Po ashtu këto instrumenta shërbejnë edhe për të marrë mendimin dhe feedback-un e studentëve për programin përkatës të studimit që ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij. Rezultatet e tyre i vihen në dispozicion autoriteteve drejtuese të institucionit, të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. <b>(E.30.8; E.40; E.40.1; E.41).</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET me qëllim vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të studentëve, zhvillon anketime/pyetsorë me studentët duke ruajtur anonimat. Po ashtu këto pyetsorë shërbejnë edhe për të marrë mendimin dhe feedback-un e studentëve për programin përkatës të studimit që ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij; zhvillon fokus-grupe me studentë si dhe vlerësime të ndryshme të stafit akademik dhe ndihmës akademik si dhe të shërbimeve që ofron institucioni. Të gjitha këto të dhëna përpunohen dhe përmbledhen në formën e një raporti periodik vlerësimi mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel institucional dhe në nivel departamenti.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Është e rëndësishme që institucioni të mbledhë mendime e të dhëna dhe të tërheqë pikëpamje nga aktorë të ndryshëm, si dhe të përqendrohet në përvojën e studentit dhe se si janë adresuar çështjet specifike të ngritura gjatë një viti akademik, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Po ashtu, raporti për vlerësimin e cilësisë duhet të konsiderojë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin prej tij. UET ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron, dhe sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, ku merr parasysh mendimin e aktorëve të brendshëm por edhe të jashtëm që shprehet në Bordet e Tregut të Punës dhe ekspertin e jashtëm si pjesë e KSBC-së. (E.2, neni 16; E.5, neni 6.1; E.8; E.12.1; E.30.1).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Organet, autoritetet dhe strukturat konkrete të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit, në Statutin dhe Rregulloren e UET-së, dhe në dokumentat që lidhen me sigurimin e cilësisë në UET. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional dhe të njësive kryesore. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë fokusohet në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin e cilësisë. (E.2; E.5; E.8; E.30.1-30.4).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantojë përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe</p>	<p>Për sigurimin e cilësisë, UET ka ngritur strukturat përkatëse që shkojnë deri në nivel njësie kryesore e bazë, që merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumentave të duhur, gjithmonë në përputhje me Rregulloren e UET-së dhe dokumentat për sigurimin e cilësisë në UET. Vlerësimi zhvillohet në bashkëpunim me struktura të caktuara institucionale dhe në këtë proces përfshihen edhe anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>

<p>studentëve të programit të studimit.</p>	<p>KSBC ka në përbërje 4 studentë dhe 1 ekspert të jashtëm si dhe stafin akademik dhe ndihmës akademik. (E.5; E.8; E.30-30.4).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vlerësimi është transparent, siguron të dhëna të vlefshme dhe respekton integritetin akademik të personelit akademik apo studentëve. Politika për sigurimin e cilësisë e UET-së është transparente, publike dhe ndikon në punën e përditshme të vlerësuesve dhe në cilësinë e raporteve të vlerësimit që ata që i hartojnë. KSBC ngrihet në nivel universiteti dhe Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme: a. Kompetencat profesionale; b. Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj.); c. Ngarkesa mësimore apo ngarkesa me kryerjen e funksioneve të tjera administrative; d. Eksperienca e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt; e. Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it. (E.8; E.30-30.4).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron dhe për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit institucioni merr parasysh mendimin e aktorëve të brendshëm por edhe të jashtëm që shprehet në: Bordin e Tregut të Punës që funksionon pranë Departamentit të Shkencave Juridike dhe ekspertit të jashtëm si pjesë e KSBC-së. Në mbledhjet e këtij Bordi të Tregut të Punës ndër të tjera është trajtuar edhe aspekte mbi tematikën “Ngritja e Cilësisë në Kurrikulat e Programeve të Drejtësisë”. (E.8; E.12.1; E.12.5, f.1-2; E.30; E.30.4).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET ka gjithmonë në vëmendje përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofron dhe sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. ku merr parasysh mendimin e aktorëve të brendshëm por edhe të jashtëm që shprehet në Bordet e Tregut të Punës dhe ekspertin e jashtëm si pjesë e KSBC-së. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional dhe të njëjste kryesore/bazë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë</i></p>

	<i>fokuset në: kontrollin e cilësisë, llogaridhënien dhe përmirësimin e cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika për sigurimin e cilësisë e UET-së është transparente dhe ndikon në punën e përditshme të vlerësuesve dhe në cilësinë e raporteve të vlerësimit që ata hartojnë. Hartimi dhe ndryshimi i politikës për sigurimin e cilësisë është po ashtu një proces gjithëpërfshirës, i hapur dhe transparent për të interesuarit, përfshi edhe studentët dhe synon krijimin e një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të UET-së. Ngritja e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion është po ashtu qëllim i politikave dhe strategjisë së UET-së në lidhje me cilësinë; garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET-it, njësisive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. (E.8; E.30 - 30.5).
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UET dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit të programit të studimit. Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit bëhet në përputhje me format e miratuara nga UET, duke e trajtuar në nivel njësie kryesore dhe bazë, e duke respektuar lirinë dhe etikën akademike dhe të dhënat personale, përsa vlejshëm. Sipas akteve rregullore, UET publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë akademike, transparencën dhe etikën akademike, LAL dhe akteve të tjera rregullore në fuqi. Në dokumentacionin e paraqitur, nuk ka një dokument të KSBC-së që lidhet me gjetjet e këtij programi studimi objekt riakreditimi,



	apo një analizë departamenti në lidhje me këto gjetje. (E.8; E.30 - 30.5).
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në përfundim të semestrit/vitit akademik, hartohet raporti mbi vlerësimet periodike dhe vjetore, në të cilin pasqyrohen rezultatet dhe bëhet një analizë e ecurisë së programeve të tij, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Institucioni përfshin të dhënat që lidhen me studentët dhe vlerësimin, apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit dhe po ashtu pasqyrohen në raportin vjetor institucional që i paraqitet autoriteteve drejtuese. Në këto raporte pasqyrohen rezultatet dhe bëhet një analizë krahasimore për ndryshimet dhe ecurinë e të dhënave të shqyrtuara, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Në dokumentacionin e paraqitur, nuk ka një dokument të KSBC-së që lidhet me gjetjet e këtij programi studimi objekt riakreditimi, apo një analizë departamenti në lidhje me këto gjetje. Formatet e pyetësorëve përpunohen përmes programit për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion drejtuesëve të Universitetit, si dhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të follow-up, që shërbejnë për vlerësimin e performancës akademike në fund të vitit. (E.8; E.30.5 - 30.16; E.41).
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UET çdo vit harton një raport vjetor, ku synon të analizojë situatën dhe impaktin e veprimtarive në funksion të cilësisë, duke analizuar performancën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë. Përdorimi i të dhënave të monitorimit dhe vlerësimit përdoret ndër të tjera për: përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe akreditimin; për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit, të shërbimeve dhe të menaxhimit; për planifikimin vjetor dhe strategjik të UET-së; për përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Në kuadër të cilësisë, monitorimi sigurohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UET, duke filluar nga departamenti, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e KSBC. (E.8; E.30.5 - 30.16; E.41).
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari	Në UET ka një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për

<p>periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit. Janë organizuar në mënyrë periodike disa veprimtari me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Informacioni shpërndalet përmes rregulloreve, studentëve në struktura të ndryshme përfaqësuese, këshillit studentor, javës së orientimit, guidës UET.</p> <p><i>GVJ mendon se në funksion të rritjes së cilësisë, departamenti duhet të zhvillojë më tepër aspektin analitik në lidhje me performancën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë. NJSBC ka një plan punë të aktiviteve të saj, por GVJ nuk evidentoi ndonjë aktivitet konkret me personelin dhe studentët më qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së këtij program studimi. (E.8; E.30.1 - 30.9; E.41).</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ngritja e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion është qëllim i politikave dhe strategjisë së UET-së në lidhje me cilësinë; garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET, njërive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. Në UET ka një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit. GVJ mendon se në funksion të rritjes së cilësisë, departamenti duhet të zhvillojë më tepër aspektin analitik në lidhje me performancën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë. KSBC ka një plan punë të aktiviteve të saj, por GVJ nuk evidentoi ndonjë aktivitet konkret me personelin dhe studentët më qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së këtij program studimi; dhe po ashtu nuk na u vu në dispozicion raporti i fundit i kësaj njësie për programin e studimit objekt riakreditimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “E Drejtë Publike dhe Ndërkombëtare”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë Publike dhe Ndërkombëtare” me dy profile “E Drejtë Penale”, “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese” ofrohet në gjuhën shqipe, është i organizuar në lëndë e module të cilat janë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);
2. Programi i studimit mbështetet nga një staf akademik i përgatitur në kontekstin e mësimdhënies dhe didaktikave mësimore, që nxit mendimin krijues dhe shkencor te studentët. Ai mbështetet nga një infrastrukturë cilësore në procesin e mësimdhënies dhe në mjediset e tjera mbështetëse;
3. UET ka marrëveshje bashkëpunimi për të ofruar një ndërlidhje sa më të mirë ndërmjet universitetit dhe aktorëve të tregut të punës, në funksion të punësimit të studentëve por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Gjithashtu është rritur edhe shkalla e bashkëpunimit me institucione të tjera vendase apo të huaja;
4. Departamenti i Shkencave Juridike, që është përgjegjës për programin e studimit MSH “E drejtë publike dhe ndërkombëtare”, ka të angazhuar personel akademik me përvojën e duhur në fushën e të drejtës publike, kushtetuese, penale. Personeli akademik me kohë të plotë i Departamentit të Shkencave Juridike, në përputhje me komizën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit;
5. UET ka investuar në sisteme të cilat mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. UET disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. UET ka një sistem nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim, i cili quhet UMIS. Ndërsa, aktiviteti i tyre akademik – mësimdhënës, administrohet prej sistemit LMS;
6. Biblioteka e UET-së është abonuar për një periudhë 5- vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online);
7. UET ka politikën e tij të bursave që aplikon sipas specifikave dhe llojet e bursave që ofrohen. Kategoritë e bursave që ofrohen nga UET janë: bursë e plotë dhe gjysëm bursë;

8. UET ka procedura e struktura të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, sikurse ruan edhe kontaktet pas diplomimit, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim plotësohet me këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik;
9. Institucioni vlerëson në mënyrë periodike cilësinë, përmes instrumentave të adoptuar për këtë qëllim. Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si dhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore;

**b. Pika të dobta:**

1. Fonde të kufizuara për kërkimin shkencor dhe mbështetjen e stafit akademik të departamentit të shkencave juridike në aktivitete botuese, kërkimore-shkencore; *(Standarti II.6, Kriteri 4)*
2. Personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi jo gjithmonë përmbush kriterin e gradës dhe titullit, në lidhje me kërkesat ligjore për stafin që aktivizohet në programin e ciklit të dytë MSH; *(Standarti IV.1, Kriteri 1)*
3. Në rregullore parashikohet ndjekja e këtij programi studimi nga shtetas të huaj, kur programi ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, gjë që është kufizim për studentët e huaj që mund të aplikojnë në këtë program studimi; *(Standarti V.1, Kriteri 3)*
4. Mungesa e analizës së të dhënave (mbledhur nga strukturat e cilësisë) në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit dhe përmirësimit e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë së këtij program studimi; *(Standarti VI.5, Kriteret 2,3,5)*

**Rekomandime**

1. Që ky program studimi “E drejtë publike dhe ndërkombëtare” me dy profilet e tij “E Drejtë Penale”, “E Drejtë Publike dhe Kushtetuese” të plotësojë profilin e tij dhe ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare - karakterin e tij ndërdisiplinor, duhet që në të ardhmen të riorganizohet, në mënyrë që të ketë përputhje ndërmjet emërimit të programit të studimit dhe profileve të tij, përmbajtjes dhe planit mësimor;
2. Në lidhje me mbështetjen financiare që ofrohet, rekomandojmë se UET duhet të ofrojë një mbështetje më të mirë në lidhje me financimin e aktiviteteve kërkimore e botuese të stafit akademik dhe pjesëmarrje më të madhe në projekte kërkimore që lidhen me departamentin e shkencave juridike që mbulon programin e studimit MSH “E drejtë publike dhe ndërkombëtare”;
3. Në lidhje me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi, rekomandohet gjithashtu marja e masave të nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi të ketë të paktën gradën shkencore Dr. në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;

4. Rekomandohet që të bëhet vlerësimi financiar mbi kosto-efektivitetin e këtij programi studimi MSH, për një planifikim sa më të mirë të kostove të programit të studimit dhe nëse do të vijojë mbështetjen financiare nga Universiteti, nisur nga numri i vogël i studentëve dhe aplikimi i sistemit të integruar 5 vjeçar në drejtësi;
5. Pavarësisht se parashikohet ndjekja e këtij programi studimi nga shtetas të huaj, nuk ka asnjë rregullim se si do të ndiqet ky program studimi nga shtetasit e huaj. Për më tepër programi ofrohet në gjuhën shqipe. Sugjerohet që të rishikohet kjo pjesë e rregullores, ose të shtohen rregulla në lidhje me këtë kategori të mundshme studentësh të huaj që mund të ndjekin këtë program studimi;
6. Po ashtu, nuk ka rregulla specifike për kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Ndaj si kriter që duhet plotësuar, sugjerohet që në rregullore të përcaktohen rregulla të veçanta për këto grupe sociale dhe shtresa në nevojë;
7. GVJ mendon se në funksion të rritjes së cilësisë, departamenti duhet të zhvillojë më tepër aspektin analitik në lidhje me performancën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë së këtij program studimi, referuar të dhënave që merren nga instrumentat e sigurimit të cilësisë;
8. Nisur nga disa pasaktësi/parregullsi në regjistrat që administrojnë sekretaria mësimore, të vërejtura gjatë vizitës në institucion, GVJ rekomandon plotësimin me korrektesë, saktësi dhe në kohë të rubrikave të regjistrave që administrojnë sekretaria mësimore (Regjistrin themeltar, Regjistrin e rezultateve akademike të studentit si dhe Regjistrin e Diplomave). Po ashtu, rekomandohet të bëhet kujdes në plotësimin e të dhënave në këto regjistra, si dhe të evitohen korrigjimet;

### **Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Public and International Law"**

#### **a. Strengths and affirmations:**

1. The Master of Science study program in "Public and International Law" with two profiles "Criminal Law", "Public and Constitutional Law" is offered in the Albanian language, and it is organized into courses and modules which are evaluated in credits, in accordance with domestic legislation in force and according to the European Credit Transfer System (ECTS);
2. The study program is supported by a professional academic staff in the context of teaching and teaching didactics, which encourages creative and scientific thinking of students. It is supported by a quality infrastructure in the teaching process and other supporting facilities;
3. UET has cooperation agreements to provide the connection between the university and the actors of the labor market at its best, in order to employ students but also to be closer to the needs of the labor market and their reflection in the study program. The degree of cooperation with other local or foreign institutions/partners has also increased;

4. The Department of Legal Sciences, which is responsible for the Master of Science study program "Public and International Law", has engaged academic personnel with appropriate experience in the field of public, constitutional and criminal law. The full-time academic staff of the Department of Legal Sciences, in accordance with the applicable legal framework and internal regulatory acts, covers the teaching load for the study program;
5. UET has invested in systems that support academic staff and students in the learning/teaching process. UET has an internal institutional management system and makes it available for administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activity for the study program. UET has a system through which it manages all information related to students and their activity, from registration to graduation that is called UMIS. Meanwhile, their academic-teaching activity is administered by the LMS system;
6. The UET library is subscribed for a period of 5 years to the electronic libraries Sage & Ebsco as well as Questia The UET library is part of the COBISS system (Common online bibliographic system and services);
7. UET has its own scholarship policy that applies according to the specifics and types of scholarships offered. The categories of scholarships offered by UET are full scholarship and half scholarship;
8. UET has special procedures and structures for reception, orientation, counseling of students, management of complaints and problems. The Office of Career Counseling and Student Care follows the progress of the student's studies, from the moment of registration, until his/her graduation, as well as maintains contacts after graduation, offers advice on academic and student issues. This service is complemented by the counseling provided by the academic staff during tutorial and academic counseling hours;
9. The institution periodically evaluates the quality through instruments adopted for this purpose. Quality assurance is achieved through the involvement of academic and administrative staff, taking the opinion of students and members of the Labor Market Boards, as well as cooperation with ASCAL and other responsible state structures;

**b. Weaknesses:**

1. Limited funds for scientific research and support for the academic staff of the legal sciences department in publishing, and research-scientific activities; (*Standard II.6, Criterion 4*)
2. The academic personnel engaged in the implementation of this study program do not always fulfill the criterion of academic title, in relation to the legal requirements for the staff activated in the Master of Science program; (*Standard IV.1, Criterion 1*)
3. The regulation foresees the possibility of foreign citizens to attend this study program, but the program is offered only in the Albanian language, which is a limitation for foreign students who can apply to this study program; (*Standard V.1, Criterion 3*)

4. The lack of data analysis (gathered by the quality structures) in order to increase the quality of the study program and the continuous improvement of the quality standards of this study program; *(Standard VI.5, Criterion 2,3,5)*

### **Recommendation**

1. In order this study program "Public and International Law" with its two profiles "Criminal Law", "Public and Constitutional Law" completes its profile and the academic offer of the Faculty of Legal, Political Sciences and International Relations - its interdisciplinary character, it should be reorganized in the future, so that there is a match between the name of the study program and its profiles, content and curricula;
2. Regarding the financial support provided, we recommend that UET should provide better support in terms of financing the research and publishing activities of academic staff and greater participation in research projects related to the department of legal sciences covering the Master of Science study program "Public and International Law";
3. As for the academic staff engaged in this study program, it is also recommended to take the necessary measures to contract qualified academic staff engaged in the implementation of this study program that have at least the scientific degree "Doctor" in order to fulfill the legal requirements in force, for the appropriate level of academic qualification;
4. It is recommended that a financial assessment be made on the cost-effectiveness of this Master of Science study program, for a better planning of the costs of the study program and if the financial support from the University will continue, based on the small number of students and the application of the 5-year integrated system in law program;
5. Despite the fact that this study program is expected to be followed by foreign nationals, there are no specific provisions on how this study program will be attended by such students (foreigners). Moreover, the program is offered only in the Albanian language. It is suggested to revise this part of the regulation, or to add rules regarding this possible category of foreign students who can attend this study program;
6. Likewise, there are no specific rules on special criteria for the selection of candidates with special abilities, minorities and marginalized groups. Therefore, as a criterion that must be met, it is suggested that special rules be defined in the regulations for these social groups and strata in need;
7. GVJ suggests that in order to increase the quality, the department should further develop the analytical aspect regarding the performance and continuous improvement of the quality standards of this study program, referring to the data obtained from the quality assurance instruments;
8. Based on some inaccuracies/irregularities in the registers administered by the teaching secretariat, observed during the visit to the institution, GVJ recommends the correctness, accuracy and timely completion of the sections of the registers administered by the teaching secretariat (Basic Register, Register of the student's academic results as well as the Register of Diplomas). Also, it is recommended to be careful in completing the data in these registers, as well as to avoid corrections;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>			X	
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X